

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7552 E enjte 7 Qershor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion Ditës

Endhe pse kanë kaluar 27 vjet nga rënja e regjimit komunist shqiptar, vazhdon që të ketë shumë shqiptarë të Kosovës dhe trojeve të tjera shqiptare në ...
Vijon në faqen 20

Nga ADRI NURELLARI

Roli i Enver Hoxhës për Kosovën dhe çështjen kombëtare



Opinion Hapur

Nga ALBENS ALITE

Të dashur Shkëlqesi, emri im është Albens Alite, ish-drejtor i Njësisë së Menaxhimit të Projektit (Nj.M.P) të "Projekt Ndërtimit të Rrugës ...
Vijon në faqen 21

Më shkatërruan brenda natës, hetimi pa paragjykime sot është utopi



ALUIZNI: Objektet e tyre nuk janë të braktisura

Artan Lame u kërkon ndjesë "Erjoni" sh.p.k dhe 8 kompanive: Lista ishte me gabime

Publikohet edhe lista me kompanitë që 'Agjencia' propozon të mos marrin më leje

ORNELA MANJANI

ALUIZNI u kërkon ndjesë nëntë subjekteve, të cilat i ka përfshirë gabimisht në listën e ndërtimeve që kanë shkelur lejet e ndërtimit dhe kanë braktisur objektet pa pajisur banorët me dokumentet e pronësisë. Në një ...
Në faqen 7

U GJETEN NE VITIN 2010, QENDRUAN PER 8 VITE NE MORGUN E KRYEQYTETIT

VARRI MASIV NE DAJT, NIS IDENTIFIKIMI I KUFOMAVE

Qeveria shqiptare firmos marrëveshjen me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur. Luigj Ndou: Do të identifikohen eshtrat e gjetura në 2010



(Në foto) Takimi i Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur me Gentjana Sulën në Tiranë

Në faqen 18

PAKTI ME SHQIPERINE

Ministri grek i Mbrojtjes, Kammenos: Do zgjerojmë ujërat tona territoriale, marrim pasurinë nën det

Në faqen 2

KËSHILLI BASHKIAK

Lista e plotë me 217 familjet në nevojë që do të trajtohen me bonus strehimi

Në faqen 14

VENDIMET 1993-2008

10 mijë pronarët në Korçë, shqyrtimi nga ATP dhe procedurat për t'u njohur me ecurinë

Në faqen 16-17

KESHILLAT

Mjeku popullor Merja: Si të frenoni psoriasis me bimë medicinale, ç'duhet të dini

Në faqen 12

ADMINISTRATORI URON GRUPIN FITUES



"Luarasi" zhvillon forumin ekonomik për studentët, dekani Spaho: Diskutim pa paragjykime

Në faqen 13

Në pranga dy bashkëpunëtorët që morën pjesë në vrasjen e Vasil Dervishajt

Ekzekutimi i biznesmenit, kush janë dy autorët

Shkak, konflikti për biznesin mes viktimës dhe agresorëve

Dy ditë pas vrasjes me plumb në kokë të biznesmenit Vasil Dervishajt, policia e Vlorës ka zbardhur ngjarjen e rëndë që tronditi qytetin bregdetar. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së këtij qaraku dhe bënë me dije se janë identifikuar dy autorët e krimit. Bëhet fjalë për



shtetasit me inicialet E.A., 31 vjeç dhe A.C., 28 vjeç, të dy lindur në Tepelenë dhe banues në Vlorë. Ndërkohë që kanë përfunduar në pranga dy bashkëpunëtorët. Të arrestuarit janë: Nekid Arapi, 21 vjeç dhe Amarildo Grembi (Muka), 28 vjeç ...
Në faqen 8

PAKTI DETAR MINISTRI GREK

Ministri grek i Mbrojtjes lëshon deklaratën para paktit me Shqipërinë

Kammenos: Do zgjerojmë ujërat tona territoriale, marrim pasurinë nën det

Marrëveshja për kufirin detar Shqipëri-Greqi pritet në qershor

Ministri i Mbrojtjes së Greqisë Panos Kammenos deklaroi dje, gjatë një aktiviteti në Athinë se së shpejti Greqia do të zgjerojë ujërat territoriale. Ai theksoi se Greqia do të zgjerojë ujërat territoriale për të marrë pasurinë nën det, por pa specifikuar ku.

"Ne jemi në një moment të rëndësishëm në historinë e kombit, shumë shpejt do të "zgjerojmë" ujërat tona territoriale, njohjen e Zonave ekonomike ekskluzive, shfrytëzimin e pasurisë nënujore dhe vendi ynë do të hyjë në një epokë të re. Ne po dalim nga kriza financiare dhe në të njëjtën kohë Greqia është shndërruar në një vend që prodhon gaz dhe ndoshta edhe më vonë naftë", -u shpreh Panos Kammenos. Ministri grek i Mbrojtjes gjatë fjalës së tij nuk ka specifikuar se për cilat territore bëhet fjalë, ndërsa deklaratat e tij vjen në një moment që Athina zyrtare është në bisedime me Shqipërinë për kufirin detar dhe zonat ekonomike. Referuar deklaratave të ministrit Kotzias pak javë më parë, marrëveshja mes Shqipërisë dhe Greqisë për kufirin detar pritet që të arrihet brenda qershorit. Ndërkohë ministri grek i mbrojtjes njihet për deklaratat e tij kundër Shqipërisë. Në dhjetor të 2016, Kammenos shfrytëzoi një vizitë blic në një nga pikat kufitare me Shqipërinë për t'i përcjellë një mesazh të fortë Tiranës zyrtare. I pranishëm në garnizonin ushtarak kufitar në Mollivdosk-epasti, në kufi me Shqipërinë, i veshur me kamuflazh dhe në praninë e gjeneralëve më të lartë të ushtrisë greke, Kammenos ka folur prerë duke paralajmëruar Tiranën se "Greqia nuk mund të pranojë sfida dhe referenca që ndikojnë në historinë dhe të drejtën ndërkombëtare". Duke iu përgjigjur disa deklaratave të kryeministrit Rama në atë kohë, Kammenos tha: "E kam fjalën edhe për deklaratat e fundit të z.Rama, për sajatat antihistorike që ai flet e që na sjellin përsëri në kujtesën bashkëpunëtorët e nazimit. Ishin ata që dolën në anën e humbësve. Ata ishin në anën e mundur në luftë. Ne nuk do të pranojmë sfida të tilla dhe nuk do të pranojmë raporte të tilla, të cilat dëmtojnë dhe in-



Panos Kammenos, ministri grek i Mbrojtjes

Michael Roth, Ministër Shteti për Europën pranë Ministrisë së Jashtme Federale në një artikull të gjatë për integrimin e Ballkanit Perëndimor në Union deklaroi se duhet të hapen negociatat për Shqipërinë dhe Maqedoninë, pasi do të ishte një sinjal inkurajimi dhe shpresë, sidomos për të rinjtë e dy vendeve. Michael Roth shprehet se Shqipëria ka ndërmarrë një reformë të thellë e të pashembullt në drejtësi. Ai thotë se Ballkani Perëndimor është guri i provës për suksesin e qëndrueshëm të modelit evropian, prandaj BE sipas tij duhet t'u tregojë, që e ka seriozisht duke hapur negociatat. Ai e nis shkrimin e tij duke kujtuar se Komisioni i Bashkimit Evropian rekomandoi më 17 prill çeljen e bisedimeve të anëtarësimit me Shqipërinë dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. "Tani është e rëndësishme të merren vendime të menjëhershme duke mbajtur

Ministri i Shtetit gjerman: Reforma në drejtësi, e pashembullt

Michael Roth: Çelja e bisedimeve me Shqipërinë, sinjal inkurajues



Michael Roth, ministër Shteti për Europën

në konsideratë faktorë gjeopolitikë dhe strategjikë sikurse edhe interesat tona ekonomike dhe ato të sigurisë", -shprehet Roth. Ai përmend edhe faktorët që rrezikojnë ta bëjnë për vete Ballkanin. "Kina është aktive në rajon dhe po aktivizon investime strategjike para së gjithash në infrastrukturë. Rusia kuron his-


përgjigjen homologut të saj grek. Me anë të një postimi në rrjetin social "Facebook" Kodheli shkroi se "NATO u krijua për të bashkuar ven-

torikisht marrëdhënie të ngushta me vendet e krishterimit ortodoks dhe krijon varësi përmes furnizimit me energji dhe armatime. Disa shtete arabe kërkojnë një identifikim më të qartë të islamit konservativ, i cili nuk korrespondon me islamit e orientuar kah perëndimit në Ballkan. Kjo bie ndesh me interesat tona. Sepse Ballkani

det demokratike të hemisferës veriore përballë çdo rreziku totalitar. Por sot e kam të vështirë të kuptoj pse ndonjë politikan në Ball-

DEKLARATA

"Ne jemi në një moment të rëndësishëm në historinë e kombit, shumë shpejt do të "zgjerojmë" ujërat tona territoriale, njohjen e zonave ekonomike ekskluzive, shfrytëzimin e pasurisë nënujore dhe vendi ynë do të hyjë në një epokë të re. Ne po dalim nga kriza financiare dhe në të njëjtën kohë Greqia është shndërruar në një vend që prodhon gaz dhe ndoshta edhe më vonë naftë", -u shpreh Panos Kammenos.



Kryeministri Edi Rama gjatë takimit me koordinatore të Platformës së Bashkëqeverisjes së bashkëpunëtorëve

Dërguti-Ruçi: Hiqet kontrolli për shtetasit në 3 pika Kosovë-Shqipëri

Kreu i Kuvendit Gramoz Ruçi, u takua dje, me delegacionin e Kuvendit të Kosovës, të kryesuar nga nënkryetarja, Aida Dërguti. Delegacioni kosovar e informoi Kryetarin e Kuvendit mbi dy rezolutat e miratuara ditët e fundit prej Kuvendit të Republikës së Kosovës, Rezolutën Nr. 06-R-004 "Për heqjen e Roamingut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë", dhe Rezolutën Nr.06-R-005 "Për heqjen e tërësisht të kontrollit për hyrje/daljet e shtetasve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë nëpërmjet pikave të kalimit kufitar në pikat kufitare: Vermicë, Qafë Prush, dhe Qafë Morinë". Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, u shpreh dakord me propozimet e delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të përshira në rezolutat e miratuara. "Është detyra e kuvendeve të të dy vendeve", -nënvizoi kryetari Ruçi, "të lehtësojmë bashkëpunimin e gjithanshëm midis Shqipërisë e Kosovës, në mbështetje të interesave të qytetarëve. Për të dy palët ekziston vullneti i plotë dhe i qartë politik. Këto rezoluta janë një hap pozitiv, por duhen parë me kujdes teknikalitetet e zbatimit të tyre për qeveritë dhe institucionet e të dy vendeve". Në takim u bisedua edhe për çështje të tjera të bashkëpunimit dypalësh në fushën e energjisë, njehsimin të diplomave, plotësimin të standardeve të integritimit etj.

Perëndimor nuk është aspak oborri i pasmë i Europës, përkundrazi ai është atrium i shtëpisë evropiane", -u shpreh Rith. "Shqipëria ka ndërmarrë një reformë të thellë e të pashembullt në drejtësi. Nëse rezultoni me sukses me ajo do ta çojë vendin shumë përpara, veçanërisht në luftën kundër krimit të organizuar", -tha Roth, duke analizuar edhe zhvillimet në Maqedoni. Ai tha se "në të dyja vendet, qeveritë reformuese janë nënë në shënjestër të vazhdueshme nga opozita". "Çelja e bisedimeve do të ishte një sinjal inkurajues për njerëzit në të dy vendet. Ne duhet t'u tregojmë, që e kemi seriozisht", e mbyll Michael Roth.

kan vesh uniformë ushtarake dhe përpiqet të ngrejë fantazma të së shkuarës. Kanë ikur kohët e satrapëve. Give peace a chance".



Vendimi i qeverisë për diasporën, çmimi "Ambasador i Kombit", për kontribuuesit

Qeveria miratoi në mbledhjen e saj të përjavshme pro pozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko, vendimin për "përcaktimin e rregullave të hollësishme për kushtet dhe mënyrën e zgjedhjes së përfaqësuesve të Këshillit Koordinues të Diasporës" dhe për "Kriteret dhe mënyrën e ndarjes së çmimit 'Ambasador i Kombit'". Vendimi i parë lidhet me ngritjen e Këshillit Koordinues, për përfaqësimin dhe koordinimin e marrëdhënieve me diasporën. Këshilli Koordinues i Diasporës, i cili do të përbëhet nga 15 anëtarë identifikon problemet e diasporës, i propozon ministrit përgjegjës për diasporën veprime për zgjidhjen e tyre, përcakton linja orientuese për hartimin e strategjisë për diasporën etj. Në aktivitetet e Këshillit marrin pjesë kryeministri dhe ministrat kryesorë. Ndërkaq, sipas vendimit të dytë, çmimi "Ambasador i Kombit" u jepet personave që kanë dhënë kontribut në fusha të tilla si veprimtari humanitare, arsim, shkençë e teknologji, kulturë etj. Propozimet lidhur me përfaqësuesit e suksesshëm të cilëve do t'u jepet çmimi, do të bëhen nga ambasadorët e Republikës së Shqipërisë të akredituar jashtë vendit.

Bushati: Shqipëria pret vendimin për hapjen e negociatave për anëtarësim në BE

Shqipëria shpreson shumë që Bashkimi Evropian të vëndosë për fillimin e bisedimeve për anëtarësimin e vendit ish-komunist në mbledhjen e Këshillit Evropian më 28-29 qershor, për të ndihmuar cëmtimin e tranzicionit të saj në ekonominë e tregut", tha ministri i Jashtëm i vendit në një intervistë për "The Japan Nees" të hënë në Tokio. "Ka ardhur koha që BE-ja të nisë negociatat me Shqipërinë për anëtarësim", tha ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati. Lidhur me zgjerimin e BE-së, Bushati përshëndeti raportin e Komisionit në shkurt, i cili sugjeron që vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë, mund të bëhen anëtare të BE-së deri në vitin 2025. "Ne e shohim atë si një faktor motivues", për të përshpejtuar reformat dhe për të përmbushur kushtet për anëtarësim", tha ai. Interesi i përtërrirë i BE-së për Ballkanin, madje edhe në kohën kur ka grindje të brendshme, të tilla si rritja e forcave kundër Unionit dhe reagimi kundër migrimit shihet gjerësisht si një përpjekje për të luftuar ndikimin në rritje të Rusisë dhe Kinës në rajon. "Ne kemi dëgjuar liderët evropianë që flasin për rrezikun që Ballkani Perëndimor të përçahet ose të bjerë nën ndikimin e aktorëve të tjerë", tha Bushati. Ai theksoi angazhimin e Shqipërisë ndaj demokracisë liberale, duke renditur disa vlera si të drejtat e njeriut, ndarjen e pushteteve dhe respektimin e pakicave kombëtare. Është e rëndësishme "që BE të vazhdojë të tregohet e fortë dhe e bashkuar kur përballet me Rusinë për çështje në të cilat nuk ndajmë të njëjtin mendim", tha ai.

Ankesat e qytetarëve në 'Platformën e Bashkëqeverisjes', paralajmëron kryeministri

Rama: Nga 10 mijë denoncime janë ndëshkuar 150 punonjës, vëzhgoheni

"Bashkëpunim për të pasur zero vonesa, zero rryshfet"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama lajmëroi dje se 150 punonjës të shtetit janë ndëshkuar pse nuk u kanë shërbyer qytetarëve. Në një takim me koordinatorët të 'Platformës së Bashkëqeverisjes' dhe qytetarëve që kanë marrë zgjidhje për problemet e tyre pasi i janë adresuar 'Platformës', Rama u shpreh dje: "Mund të shkojmë në zero vonesa dhe zero rryshfete, duke bërë të qartë që çdo punonjës në detyrë është i vëzhguar nga çdo qytetar që ka lidhje me detyrën në funksion të zgjidhjes së problemit. Platforma ka arritur në 10 mijë raste të adresuara nga qytetarët, kryesisht ankesa të drejtpërdrejta për halle të tyre individuale apo familjare, por edhe adresime për shqetësime të komunitetit, për nisma komunitare, si dhe për ngritjen e zërit lidhur me çështje të ndryshe të qeverisjes. Javën e fundit kemi pasur 1 mijë raste, që do të thotë që, shpresoj, ngarkesa e 'Platformës' do të shkojë duke u rritur, sepse ky është qëllimi", u shpreh Kryeministri. "Unë jam 100% i bindur se sa më shumë qytetarë të angazhohen duke shpenzuar 3 minuta për të ngritur zërin e tyre, për ta adresuar ankesën e tyre drejtpërdrejtë tek anëtarët përkatës i qeverisë që mbulon sektorin nga ku vjen shqetësimi, aq më shpejt do të arrijmë të kemi një administratë që do të shërbejë me zero vonesë dhe me zero rryshfet", theksoi kryeministri Rama. Sipas tij, "kjo është një rrugë ku jo vetëm zgjidhim probleme, por edhe rrisim vetëdijen e punonjësve të administratës për fuqinë e çdo njeriu të zakonshëm, i cili kur shfaqet në një zyrë, apo në një sportel, mund të duket, siç duket tradicionalisht, i pambrojtur dhe në pamundësi për t'u imponuar për të drejtën që i takon me ligj. Ndërkohë që me 'Platformën', çdokush, i çfarëdo kategorie sociale, nga çfarëdo pozicioni gjeografik, kthehet në një njeri që ka të gjithë fuqinë vetë qeverisë, me aksesin e drejtpërdrejtë në qeveri. Qëllimi i 'Platformës' është i dyfishtë, jo vetëm të zgjidhim problemet, por edhe të identifikojmë të gjithë ata që janë bartës të kësaj inercie që ne duam të ndalim brendapërbrenda administratës, të gjithë ata që bartin zakonet e



ELISA SPIROPALI
Koordinatorja e 'Bashkëqeverisjes', deputetja Spiropali u shpreh dje, në takim se "Platforma çdo ditë e më shumë po bëhet dinamike. Njerëzit sidomos në Ministrinë e Drejtësisë i përqrasen kësaj 'Platforme', me një hezitim shumë të madh, duke qenë se janë ende vite dhe vite për të zgjidhur problematikat e tyre".

Qato në Librazhd: Reformat na dhanë rekomandimin për negociatat

Balla: Sot nuk guxon më njeri të marrë para për të bërë drejtësi

Kreu i grupit parlamentar të PS, Taulant Balla, i shoqëruar nga ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Sonila Qato u përballën dje me banorë të njësisë administrative të Orenjës në Librazhd. Duke folur për shërbimet ndaj qytetarëve, Balla përmendi reformat në drejtësi. "Një gjyqtar dhe një prokuror sot dolën përpara vetingut. Nëse do ta kalojnë apo jo, kjo është çështje e tyre, por e rëndësishme është që ne i qëndruam besnikë angazhimit që morëm para një viti që do ta çojmë vetingun deri në fund. Efekti i parë i reformës në drejtësi është se sot nuk guxon më njeri të marrë para për të dhënë drejtësi. E dyta është ajo që po luftojmë të gjithë, është hapja e negociatave. Ne do të kishim dashur që në këtë proces të kishim



edhe opozitën për të lobuar së bashku për hapjen e negociatave. Do të ishte mirë që opozita të ishte me ne për të kërkuar hapjen e negociatave, sepse nga hapja e negociatave nuk përfiton PS, por përfitojnë shqiptarët", tha Balla. Edhe ministria Qato në të njëjtën linjë thek-

soi rëndësinë e hapjes së negociatave dhe rolin e madh që ka pasur Reforma në Drejtësi në këtë drejtim: "Dy arrijtë kryesore të këtij mandati qeverisës, që vijnë si pasojë e një pune të madhe gjatë mandatit të kaluar, është rekomandimi pozitiv për çeljen e negociatave. Ky rekomandim nuk do të kishte ardhur nëse mandatin e kaluar nuk do të kishte ndodhur i gjithë ai proces i Reformës në Drejtësi", u shpreh Qato. "Nëse sot Europa dhe të gjitha shtetet anëtare nuk do të kishin parë se si do të jetësohej nga dita në ditë kjo Reformë në Drejtësi, duke çmontuar nga pallati i drejtësisë të gjitha ata që nuk kanë dhënë drejtësi në këto 25 vite demokraci, nuk do të kishin dhënë mendimin e tyre pozitiv", tha Qato.

këqija të administratës dhe që shkelin të drejtat e qytetarëve për dembelizëm, për indiferentizëm, apo akoma më keq, për arsye korruptive dhe menjëherë fillon një proces administrativ hetimi për të nxjerrë përgjegjësitë", u shpreh Rama. "Sot numërojmë 10 mijë raste të adresuara në 'Platformë', por janë afro 150 raste punonjësish të administratës që kanë marrë ndëshkimet e merituar, që nga ndjekja penale

deri tek paralajmërimi për largim nga puna për vonesa në trajtimin e problemeve të qytetarëve. Është një numër shumë i vogël, sepse edhe në këtë aspekt duhet të luftojmë çdo ditë, të gjithë së bashku, me mbrojtjen që u bëhet shpesh punonjësve të administratës, që janë faktikisht shkaktarët e shqetësimeve të qytetarëve. Ky është një proces ku rritja e besimit të njerëzve për 'Platformën' do

të na sjellë rezultate gjithmonë e më pozitive", theksoi ai. Pasi ka dëgjuar disa nga ata që kanë zgjidhur problemet përmes 'Platformës' Rama tha: "Këtu fle një nga 'lepujt' të së mëdhenj të ferrave të së shkuarës dhe këtu kemi një nga çelësat më të sigurt për të hapur derën e së ardhmes dhe për të pasur një administratë që është 100% në funksion të qytetarëve".

REFORMA ZGJEDHORE DISKUTIMI

Eksperti i 'Venecias' liston rreziqet dhe përfitimet e futjes së teknologjisë në zgjedhje

"Lokalet", Bylykbashi: Projekt pilot për votim e numërim elektronik

OSBE: Për formulën i takon Shqipërisë të vendosë

Valentina Madani

Opozita këmbëngul që në zgjedhjet lokale identifikimi biometrik, votimi dhe numërimi elektronik te aplikohen nëpërmjet një projekti pilot; në mënyrë që pastaj në zgjedhjet e ardhshme parlamentare teknologjia të shtrihet në të gjithë procesin zgjedhor. Qëndrimin e PD-së e shprehu dhe bashkëkryetari i komisionit të reformës zgjedhore Oerd Bylykbashi, gjatë një tryeze me ekspertët më të mirë në fushën e votimit elektronik. Partia Demokratike kërkon futjen e teknologjive në votim, pasi sipas saj, në këtë mënyrë garantohet identifikimi i saktë i votuesve, verifikimi dhe parandalimi i votimit të shumëfishtë, shmanget kontrolli i votës në mënyrë politike, korruptive apo kriminale dhe përshpejtohet në tërësi gjithë procesi deri në nxjerrjen e rezultati. Sipas tij puna përgatitore vazhdon dhe brenda qershorit do të trajtohen tri çështjet më prioritare: që është votimi elektronik, shit-bleja e votës dhe abuzimi me burimet shtetërore që do të jenë deri në mesin e këtij muaji. Pas qershorit nis draftrimi i ligjit nga ekspertët dhe kësaj here rol të dorës së parë do të kenë ekspertët e huaj. "Që në fillim të sesionit të ardhshëm do të kemi edhe draftet për aprovim në komision dhe parlament. I kemi dhënë një rol primar këshillës ndërkombëtare europiane, Këshillit të Europës përmes Komisionit të Venecias dhe OSBE/ODIHR dhe ekspertët të tjerë me reputacion në këtë fushë", deklaroi z. Bylykbashi. Në tryezë ishte i pranishëm edhe kreu i Kuvendit Gramoz Ruci, i cili deklaroi: "Unë jam besimplotë, që do të arrihet një produkt final në radhë të parë për implementimin e rekomandimeve të OSBE-ODIHR".

EKSPERTËT

Në emër të Komisionit të Venecias, eksperti Tarvi Martens listoi rreziqet dhe përfitimet që sjell futja e teknologjisë në zgjedhje. "Teknologjitë e reja të votimit nuk ndihmojnë drejtpërdrejt në lidhje me blerjen e



Komisioni parlamentar për Reformën Zgjedhore

REKOMANDIMET

Ekspertët ndërkombëtarë të ftuar nga Këshilli i Europës dhe OSBE-ja, bënë prezantimin e gjetjeve dhe dhanë rekomandime mbi implementimin e teknologjive të reja në votim. Bashkëkryetarët e Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore, në mënyrë të përbledhur dhanë konkluzionet përfundimtare lidhur me çështjet e diskutuara në këtë tryezë.

PD e LSI vazhdojnë bllokimin: Sot nuk do ketë seancë normale

S'ka ligje, shtyhet për dy javë seanca, rimblidhet më 21 qershor

Kuvendi do të mblidhet sot, por për shkak të mungesës së projektligjeve do të shtyhet për dy javë ndërkohë që do të rimblidhet me datën 21 qershor. Nga ana e saj opozita nuk tërhiqet nga strategjia për të mos lejuar punime normale në Kuvendin e Shqipërisë, deri në 28 qershor kur do jepet vendimi për çeljen ose jo të negociatave. Grupi parlamentar i PD-së u mblodh dje për seancën parlamentare të sotme, ndërsa mësohet se deputetët do të bllokojnë foloren ndërsa do komunikojnë me qytetarët nëpërmjet rrjeteve sociale. Edhe në komisionet



parlamentare deputetët demokratë do të mbajnë të njëjtin qëndrim duke e fokusuar diskutimin vetëm tek akuzat ndaj ministrit të Brendshëm Fatmir Xhafaj dhe kryeministrit Edi Rama, si dy persona që sipas

votës, pasi pjesa më e madhe e saj ndodh në procesin jashtë zgjedhor. Teknologjitë e Reja të Votimit ndihmojnë më shumë me mashtrimin zgjedhor, pasi ato automatizojnë procese të caktuara dhe eliminojnë faktorin njerëzor", tha z. Martens. Kurse eksperti i OSBE/ODIHR Steven Martin theksoi se i takon Shqipërisë të vendosë

për mënyrën se si do t'i organizojë zgjedhjet dhe ODIHR nuk është as pro dhe as kundër përdorimit të teknologjisë. "Rekomandohet që zbatimi pilot për votimin dhe numërimin elektronik të fillojë menjëherë përpara zgjedhjeve të radhës", deklaroi z. Martin. Shqipëria ka pasur disa reforma zgjedhore, por që pas paktit Nano-

demokratëve mbrojnë krimin dhe korupsionin. Kjo sjelle politike e Partisë Demokratike, do të vazhdojë deri në 28 qershor, e në qoftë se vendi ynë merr përgjigje negative nga Bashkimi Europian për negociatat, nuk përjashtohet që opozita të radikalizojë qëndrimet deri në bojkot të institucioneve. Në mbljedhjen e njëjave më parë të grupit parlamentar deputetët demokratë në bllok propozuan bojkotimin e kuvendit pas refuzimit të Fatmir Xhafajit për t'u dorëqever, po kryetari Lulzim Basha, doli kundër me argumentin se ky vendim mund të dëmtojë procesin integruar.

Berisha që pasoi zgjedhjet problematike të vitit 2001, që u konsiderua si një pakt për reforma dhe jo për pushtet, ligji zgjedhor është bërë me konsensus. Në raportin për zgjedhjet vendore të 2003-shtit, ODIHR e cilësoi të papërfundimtarë dhe PD dhe PS për dialog gjatë reformës së kuadrin ligjor, frymë që nuk u reflektua në zgjedhje.



Gjatë një seance parlamentare

VENDIMI

Vonesat në raportimet vjetore, deputetët fusin parlamentin në krizë

Për muajsh Kuvendi ndodhet në krizë funksionimi: debati politik dhe axhenda ditore që shpesh nuk ka përputhje me axhendën parlamentare, ka krijuar një hendek të thellë midis produktit parlamentar dhe pritshmërive të tij. Pjesëmarrja e pjesshme e opozitës në komisione, protesta e saj lidhur me aktualitetin politik, debatet politike dhe krijimi i një klime konfliktuale pune ka krijuar një rrethanë tipike për parlamentet gjysmëkë: ka seanca plenare dhe ka komisione, por puna e produkti i tyre është i pjesshëm, është i vonuar dhe me cilësi të dobët. ISP rezultoi se sipas praktikës së punës së Kuvendit në janar përcaktohet kalendari i raportimeve vjetore të institucioneve, proces që zakonisht duhet të zgjasë deri në mesin e muajit maj. Aktualisht bilanci i raportimeve është negativ: vetëm 11 institucione kanë kryer raportime të rregullta në parlament, disa të tjera kanë ezauruar raportimet në komisionet përkatëse parlamentare, por siç shihet nga tabela, parlamenti nuk ka përbushur ende detyrën e vet kushtetuese dhe ligjore për raportimet e institucioneve. Shumica e tyre ndodhen ende në pritje të normalitetit në seancat plenare dhe në punën e komisioneve.



Strategjia e opozitës, Vasili: Çdo ditë do protestohet kundër qeverisë 'Rama'

Deri në vendimin e BE për Shqipërinë në qershor, opozita ka vendosur të mos thërrasë një protestë masive. Këtë e ka shprehur kreu i LSI, Petrit Vasili në rubrikën "Opinion" në "News24", por theksoi se reagimi opozitar do të vijojë me të njëjtin intensitet. "Opozita kërkon të rrëzojë qeverinë e inkriminuar. Sot jemi në ditë më të këqija të një qeverie të zhbërë. Ndaj qytetarët reagojnë. Opozita është e vendosur të vijojë aksionin e saj me të njëjtin intensitet. Shqiptarët votuar të qeverisen nga pushetë, dhe jo nga portali, siç bën ky kryeministër", u shpreh Vasili. Duke u ndalur tek protestat e të rinjve të FRPD dhe LRI gjatë ditëve të fundit përpara Ministrisë së Brendshme, deputeti Vasili tha se të rinjtë që po protestojnë kundër Ramës dhe Xhafajit po procedohen penalisht.



Vokshi: Mazhoranca, edhe 23 ditë kohë për të larguar Xhafajn, të reflektojë

Debatet, Mima tregon klanet e fuqishme: Socialistë, çlirohuni nga "Rilindja"

"Krimi më i madh, 2.5% e shqiptarëve të varur nga kokaina"

Valentina Madani

Partia Demokratike de batoi sërish dje në komisionet parlamentare me mazhorancën, të cilës i kërkon dorëheqjen e ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Diskutimet ishin të ashpër në Komisionin e Medias në Kuvend, ku ishte thirrur kreu i AKEP-it, Ilir Zela, në lidhje me mbylljen e një portali. Por, Zela nuk i është përgjigjur thirrjes së Komisionit Kuvendor, duke sjellë që debatet të bëheshin mes deputetëve të opozitës dhe mazhorancës. Mima u bëri thirrje deputetëve socialistë që sipas tij nuk janë me Rilindjen dhe duan ta mbajnë kokën lart, të çlirohen urgjentisht nga Rilindja. Duke folur në këtë komision, deputeti i PD-së, Florjon Mima u shpreh se nuk është problem vetëm mbyllja me urdhër qeveritar i një portali, por edhe 30 mijë familjet që u është hequr asistenca. Mima tregoi edhe për 3 klanet që drejtojnë qeverinë shqiptare dhe Ministrinë e Brendshme. Deputeti demokrat foli për rotacione të klanëve në Ministrinë e Brendshme. "Shihni rotacionin e klanëve në Ministrinë e Brendshme. Klani i marjuaanës iku. Erdhi, kreu misionin e vet, e kanabizoi vendin dhe në xhiro vjetore thotë EUROPOL, 9 miliardë euro, 4 miliardë është buxheti i shtetit i Shqipërisë, 9 miliardë euro, dhe pjesa më e madhe vjen nga Shqipëria, thotë EUROPOL. Në ikje e sipër është klani i kokainës. 2 miliardë e gjysmë euro thonë Kombet e Bashkuara. Por krimi më i madh nuk është ky, krimi më i madh është se 2.5% e popullsisë është "addicted" (të varur) tek kokaina. Janë 80 mijë shqiptarë që nuk e dinë a e kanë jetën e sigurt apo jo. Kanë rënë në kthetrat e kësaj droge dhe vështirë të dalin pa një përpjekje serioze të gjithëve ne. Ka edhe një klan tjetër Klani i heroinës, siç do vijë shumë shpejt, e do të ikë edhe ai. Prandaj nuk hapen negociatat. Lexoni raportin e OSBE-së. Është ulëritës. Klithmat e tyre për një vend që do të anëtarësohet në BE, por nuk ka Gjykatë Kushtetuese. Nuk ka Gjykatë të Lartë", tha



Komisioni parlamentar i Medias

"Xhafaj", Pollo: Situata në Shqipëri është e rënduar

Deputeti demokrat, Genc Pollo deklaroi dje se në një vend normal, ministri i Brendshëm do të kishte dhënë dorëheqjen, ndërsa Fatmir Xhafaj në Shqipëri jo vetëm që nuk e dha, por u mor në mbrojtje nga kryeministri. Sipas tij, kjo sjellje politike e Ramës dhe Xhafajt tregon se situata është më e rëndë edhe nga sa duket aktualisht. "Me Saimir Tahirin nuk kam folur ndonjëherë. Me Fatmir Xhafajn jam ulur dhe kemi shkëmbyer mendime këto 15 vite. Nuk e kuptoj pse ai nuk ka dhënë dorëheqjen. Përdërsa Fatmir Xhafaj nuk e dha dorëheqjen dhe Rama e mbrojti me kosto politike, mendoj se koston janë shumë të trasha. Për vendin tim do të kishte qenë më mirë një dorëheqje", theksoi z.Pollo.



Protesta, të rinjtë e FRPD e LRI kërkojnë rrëzimin e qeverisë

FRPD dhe LRI zhvilluan sërish dje një protestë para Ministrisë së Brendshme, ku prej kohësh ministri Xhafaj është në shënjestër të akuzave. Të rinjtë e nisën protestën rreth orës 18:00 poshtë zyrës së Xhafajt, duke i kërkuar sërish dorëheqjen. Në mënyrë simbolike të rinjtë vendosën përpara ministrisë një ekspozitë me "meme" të bëra nga të rinjtë të paangazhuar politikisht, foto që qarkullojnë në rrjetet të ndryshme sociale. "Kuk-sanët janë ende në burg", "Tahiri i lirë e Xhafaj ministër". "Për 3 mijë lekë faturë energjie të papaguar kryefamiljarët janë shtyrë drejt vetëvrasjes, ndërsa Fatmir Xhafaj është ministër edhe pse ka fshehur nga drejtësia të vëllain të dënuar për trafik droge, edhe perse ai është subjekt i ligjit Antimafia për shkak të dënimit me 7 vite burg për trafik droge në Itali të vëllait të tij", këto kanë qenë disa nga "meme"-t e përdorura. Pak kohë më parë, PD publikoi një audio-përgjigje që implikonte vëllain e ministrit Xhafajt, Agron Xhafaj, ku ky i fundit pretendohet se flet me trafikantët droge. Kaq mjaftoi që prej kohësh Xhafaj të vihej në shënjestër të sulmeve, pasi akuzohet se ai mbron vëllain e tij.

"Të pajtoj vëllezërit", bën bashkë Ramën, Xhafajn dhe Tahirin

Berisha: Ata që mbrohen nga qeveria e mafies, nesër do përgjigjen rëndë

Ish-kryeministri Sali Berisha nuk i kursen sulmet dhe ironitë ndaj Edi Ramës dhe ministrave të tij, siç është rasti i Fatmir Xhafajt. Përmes një postimi në "Facebook", Berisha publikoi dje një fotomontazh ku shihet Rama, Xhafaj dhe Tahiri bashkë, ku kryeministri iu drejtohet: "Detyra ime është që t'i pajtoj dy vëllezërit droga". Po dje ish-kryeministri Sali Berisha reagoi pas ngjarjes që ndodhi në Kishën Katolike në Durrës, pasi persona ende të pайдitifikuar i vunë flakën. Përmes një statusi në "Facebook", Berisha thekson se forca e krimit nuk kursen as kishat, duke e cilësuar ngjarjen një akt vandalizimi barbar. Mes të tjerash, ish-lderi i PD-së tha se përgjegjëse për veprat që ndodhin është qeveria. "Forca e krimit" në Durrës nuk kursen as kishën! Në Durrës, qytetin ku në poli-



ci, bashki, prokurori, gjykata, ligjin e bën krimi i lidhur me nivelet më të larta të qeverisë, në një akt të pashembullt intolerancë, racizmi, vandalizimi e barbarie, me qëllimet më të zeza i vihet zjarri kishës katolike! Duke dënuar me ashpërsinë më të madhe autorët dhe nxitësit e këtij akti barbarie, që të rikujton kohërat më të zeza të diktaturës hoxhiste, i

shpreh kishës dhe klerit udhëheqës të saj solidaritetin tim më të thellë. Duke bërë përgjegjëse direkt qeverinë e krimit, i siguroj se në rast se sot ata mbrohen nga qeveria e mafies, nesër do përgjigjen rëndë së bashku me të për aktin e tyre të pashembullt satanik, kriminal e racist!", shprehet z.Berisha.

Mima. Hapjen e negociatave me Bashkimin Evropian, sipas opozitës nuk po e pengon PD-ja, por klanet e drogës, të cilët kanë marrë "peng" qeverinë dhe Ministrinë e Brendshme. Diskutimet me tone të larta teksa opozita i kujtoi shumicës se kanë edhe 23 ditë kohë të reflektojë. "23 ditë që të hiqni ministrin e Brendshëm, ta shkarkoni dhe të tregoni se e keni seriozisht plotësimin e

kritereve", deklaroi deputeti e PD-së, Albana Vokshi. Edhe deputetja Orjola Pampuri foli në Komisionin e Medias pas veprimit të AKEP për mbylljen e një faqeje që bënte satirë me qeverinë. Ndërsa deputeti i PS-së, Ismet Beqiri u shpreh: "Ishin kohëra të tjera kur digeshin redaksi, goditeshin me plumb gazetaret". "Nuk mund të jemi optimistë, si mund të shohim gotën plot,

kur jemi të dehur nga krimi dhe droga. Ndërkohë që zërat e atyre që protestojnë dëgohen deri këtu. Janë minatorët që protestojnë aty". "Kemi dy ministra njëri pas tjetrit të implikuar me trafikun e drogës. Njëri me kushërinjtë, e tjetri me vëllain. Cfarë modeli mund t'u ofrojë qytetarëve një ministër që rri nga mëngjesi deri në darkë me banda", tha deputetja Pampuri.

Rënia e euros, Sejko: Ndërrhyrje e jashtëzakonshme, do blejmë valutë

Banka e Shqipërisë ul papritur normën bazë të lekut në 1 për qind

Nisin efektet, fillon forcimi euros

Ornela Manjani

Banka e Shqipërisë ka paralajmëruar se do të hyjë në tregun valutë, duke blerë valutë, në një veprim të jashtëzakonshëm që synon që të ndalojë rënien e lirë të monedhës së përbashkët. Lajmin e bëri të ditur guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, në një konferencë për shtyp. Operacionet e blerjes së valutës do të ruajnë kohëzgjatjen e nevojshme për të arritur objektivat e deritashme tha Guvernatori i Bankës së Shqipërisë në një deklaratë për shtyp. Ky është një rast i veçantë i ndër-marrë në rrethana specifike, tha guvernatori, që po bëhet në mënyrë që të frenohet përshpejtimi i rënies së euros, që në muajin maj ka dalë përtej parametrevë. Si rrjedhojë Këshilli Mbikëqyrës mori një vendim të tillë për të ndërrhyrë në treg. "Këshilli Mbikëqyrës vendosi: Të ulë me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit, duke e zbritur atë në nivelin 1.00%; Të ulë me 0.15 pikë përqindjeje normën e interesit të depozitës njëditore, duke e zbritur atë në nivelin 0.10%; Të ulë me 0.35 pikë përqindjeje normën e interesit të kredisë njëditore, duke e zbritur atë në nivelin 1.90%"-tha Sejko. Tregu ka pasur një rritje të sasisë së euros, që ka qenë konstante që nga viti 2015. Mbiqimi nuk ka ardhur vetëm për shkak të sasisë së euro, por edhe si rrjedhojë e rritjes së pritshmërisë së agjentëve për një mbicim të kursit, që ka dalë jashtë parametrevë normale të regjimit të kursit të këmbimit dhe na ka detyruar të ndërhyjmë në treg, tha guvernatori. Guvernatori tha se leku po forcohet nga oferta për valutë dhe nga konvertimi i kapitalit të bankave. Qëllimi kryesor i operacioneve monetare do të ndërmerren vetëm për nevojë të përmbushjes së objektivave të inflacionit, pasi rënia e euros rrezikonte objektivin e inflacionit. Në Shqipëri do të vazhdojë të jetë regjimi i lirë i kursit këmbimit, por BSH ka të drejtën e saj për të rregulluar parametret e tregut, përfundoi guvernatori.

NORMA BAZË
Me një vendim të papritur, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të mërkurën uljen e normës bazë të interesit në 1%, duke vendosur një rekord të ri historik për monedhën shqiptare. Guvernatori Sejko e argumentoi vendimin e sotëm me forcimin e shpejtë të lekut ndaj euros, që po e vështirëson akoma më shumë përpjekjen e Bankës së Shqipërisë për kthimin e inflacionit drejt



Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko

objektivit prej 3%. "Këshilli Mbikëqyrës vlerëson të nevojshëm lehtësimin e politikës monetare. Ky vlerësim është në konsistencë të plotë me qëndrimet tona të mëparmshme. Në këtë këndvështrim, Këshilli vendosi të ulë me

0.25 pikë përqindje të normës bazë të interesit duke e çuar në masën 1%. Këshilli Mbikëqyrës vendosi ndër-marrjen e operacioneve të blerjes së valutës në tregun e brendshëm valutë. Operacioni i blerjes së valutës do të

eliminohet tepërcën e valutës në treg, dhe forcimin e kursit të këmbimit"-tha Sejko. Vetë ulja e normës bazë të interesit, në teori, është një masë që mund ta ndikojë direkt kursin e këmbimit. Ulja e normës bazë të interesit rrit ofertën

monetare në lekë dhe mund të sjellë zhvlerësim të monedhës vendase. Sejko njoftoi gjithashtu edhe ndërhyrje në tregun valutë për blerjen e euros, çka pritet të sjellë forcim të monedhës europiane ndaj lekut.

TRI MASAT

1. Të ulë me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit, duke e zbritur atë në nivelin 1.00%;
2. Të ulë me 0.15 pikë përqindjeje normën e interesit të depozitës njëditore, duke e zbritur atë në nivelin 0.10%;
3. Të ulë me 0.35 pikë përqindjeje normën e interesit të kredisë njëditore, duke e zbritur atë në nivelin 1.90%.

BANKA E SHQIPËRISË

Operacionet monetare do të ndërmerren vetëm për nevojë të përmbushjes së objektivave të inflacionit, pasi rënia e euros rrezikonte objektivin e inflacionit.

Tarifa për rrugën Milot-Morinë, Ahmetaj dhe Gjijnuri takim me bizneset kosovare

Ahmetaj: Sa më shumë të lëvizin bizneset, aq më shumë përfitojnë ulje

Në kuadër të konsultimit me grupet e interesit përpara rivendosjes së tarifës së kalimit të rrugës Milot-Morinë, ministri i Financave dhe Ekonomisë Arben Ahmetaj bashkë me ministrin e Infrastrukturas dhe Energjisë Damian Gjijnuri pritën në takim një përfaqësi biznesesh nga Oda Ekonomike e Kosovës. Gjatë këtij takimi u pohua rëndësia e madhe që rruga Milot-Morinë, e njohur si Rruga e Kombit, ka për zhvillimin ekonomik të dy vendeve tona dhe rritjen e shkëmbimeve tregtare. Palët u dakordësuan në qëndrime për nevojën emergjente që ka kjo rrugë për një mirëmbajtje sa më profesionale ashtu e të vazhdueshme ashtu sikurse për aplikimin e sistemit tarifor të kalimit si garanci për këtë mirëmbajtje. "Nëbiem dakord që një tarifë duhet.

Problemi është se si ta zbusim dhe mitigojmë këtë tarifë. Çdo gjë që ulet këtu prapë e paguajnë qytetarët shqiptar dhe këtë duhet ta kuptojmë, pra Buxheti i Shtetit. Megjithatë, në ngrit të shqetësimit, është bërë studimi dhe është nxjerrë kostoja e mirëmbajtjes dhe prandaj u detyruam të shkojmë tek praktika koncesionare. Rruga do minimalisht 7 milionë euro në vit për mirëmbajtje dhe do dalë kjo shumë; ose do paguajnë gjithë shqiptarët ose përdoruesit e rrugës dhe kjo është e vërteta. Nuk janë kosto të fshehura ato", u shpreh ministri Gjijnuri. Ministrat Ahmetaj dhe Gjijnuri dëgjuan me vëmendje shqetësimet e ngritura nga përfaqësuesit e biznesit të Kosovës lidhur me nivelin e tarifës dhe efektet e saj në kostot e tyre të transportit. Ata ranë dakord që bashkërisht të bëhen për-

plekjet maksimale në drejtim të gjetjes së formave lehtësuese për mjetet e biznesit që lëvizin më shpesh në aksin Milot-Morinë. Nga ana e përfaqësuesve të biznesit u hodh edhe ideja që qeveria e Kosovës mund të kontribuojë, gjithashtu, për të lehtësuar barrën financiare që krijohet nga zbritjet tarifore dhe nevojë për mirëmbajtjen e aksit rrugor. Gjithashtu, përfaqësuesit e biznesit i propozuan ministrave Ahmetaj dhe Gjijnuri që rifillimi i zbatimit të tarifës së kalimit të mund spostohet në kohë pasi të kalojë sezoni i ardhshëm turistik. "Patjetër që ka një ndërgjegjësim, në të paktën një vit e gjysmë për atë që do të bënte tarifa e rrugës. Nuk diskutohet dhe diskutimi në ekulibër midis kostos së rrugës dhe një kulturi të re, nëse duhet ta themi kështu, por edhe kostos që do t'i ngarkonte qytetarët dhe bi-



zneset ka qenë prezent. Ne jemi fokusuar në bazë të kontratës të përdoruesit e shpesh të. Kemi ndërtuar me ministrin një logjikë financiare progresiviteti, pra për t'i dhënë një mundësi atyre që e përdorin rrugën. Pra, sa më shumë e përdor rrugën me kalime për kamion le të themi, aq më shumë kë mundësi të ulës qmimin",-shtoi ministri Ahmetaj. Më tej ai u ndal tek efekti që ka në Buxhet që ndërhyrje lehtësuese në tarifën e kalimit në rrugën Milot-Morinë. "Janë gati 48-50 milionë euro që i merr përsipër Buxheti i Shtetit të Shqipërisë për periudhën e koncesionit vetëm nga këto ndryshime që po

AUDITIMET



Leskaj: Dëmi ekonomik, 110.5 mlrd lekë. Rritet borxhi tatimor e doganor

Dëmi ekonomik dhe humbjet në financat publike për vitin 2017 janë në vlerën e 110.5 miliardë lekë. Sipas raporteve të KLSH-së për vitin që lamë pas janë konstatuar shkelje financiare në të ardhurat dhe shpenzimet e kryera me vlerë 11.5 miliardë lekë. Ndërkohë që 99.05 miliardë lekë janë dëme të ardhura si rezultat i shkeljes së disiplinës financiare me performancë negative në subjektet e audituara. Kreu i KLSH-së Bujar Leskaj gjatë raportimit në Komisionin Parlamentar të Ekonomisë u shpreh se për vitin 2016 kemi rritje të detyrimeve ndaj tatimeve dhe doganave me 41% më shumë se në vitin 2015. Kështu borxhi tatimor dhe ai doganor është 51.17 miliardë lekë. KLSH vijon me kërkesën e saj për të intensifikuar bashkëpunimin me Kuvendin në përmirësimin e ligjit. Sipas Leskaj duhet që institucionet të ndërhyjnë për zbatimin e rekomandimeve që jep Kontrolli i Lartë i Shtetit edhe kur bëhet fjalë për zyrtarët e lartë.

Publikohet edhe lista me kompanitë që 'Agjencia' propozon të mos marrin më leje

Ornela Manjani

Lame i kërkon ndjesë 'Erjoni' sh.p.k dhe 8 kompanive

ALUIZNI: Lista e 30 majit me gabime, objektet e tyre nuk janë të braktisura

ALUIZNI ju kërkon ndjesë nëntë subjektëve, të cilët i ka përfshirë gabimisht në listën e ndërtuesve që kanë shkelur lejet e ndërtimit dhe kanë braktisur objektet pa pajisur banorët me dokumentet e pronësisë. Në një njoftim për mediat të drejtorisë së përgjithshme e këtij institucioni, kreu i të cilit është Artan Lame sqarohet se subjektet, mes të cilave edhe Erjoni SH.P.K, janë përfshirë në listë gabimisht. "Lista e subjekteve që u përfshinë në thirrjen e bërë prej nesh në datë 30 maj, gabimisht ose për shkak se shkeljet e tyre nuk kanë të bëjnë me kategorinë e objekteve të braktisura. Ju kërkohet ndjesë këtyre subjekteve për shqetësimin e krijuar dhe mbetemi në dispozicion për sqarime të mëtejshme"-thuhet në njoftim.

NDËRTIMET
Pas publikimit të listës një javë më parë, të të gjithë subjekteve ndërtuese, të cilat kishin probleme me procesin e legalizimit të pallateve, shkelje në lejen e ndërtimit apo edhe ndërtesa të braktisura, ALUIZNI publikon këtë të mërkurë

katër lista të tjera. "Siç jeni në dijeni, pas disa paragrafimeve, më dt. 30 maj

ALUIZNI publikoi listën paraprake e subjekteve ndërtuese me probleme në

procesin e legalizimit të pallateve me shkelje në lejen e ndërtimit apo të braktisur

nga ndërtuesit. Pas kësaj subjekteve ju la një tjetër afat një-javor për t'u konsultuar me punonjësit tanë, të shprehin pozicionin e tyre, pretendimet apo dokumentacionin në dispozicion"-thuhet në njoftimin e ALUIZNI-t. ALUIZNI deklaroi se 122 subjekte ndërtues "ju përgjigjen thirrjes sonë dhe gjatë ditëve nga 31 maji deri dje, kontaktuan me drejtoritë tonë në Tiranë dhe u përfshinë në procesin e legalizimit të pallateve të braktisura apo me shtesa pa leje, duke paraqitur dokumentacion të nevojshëm procedural". Drejtoritë e Përgjithshme e ALUIZNI-t bën publike rezultatet përfundimtare të këtij procesi njëjavor pune dhe kontak-

tesh intensive, duke publikuar 4 lista. Në listën e parë janë subjektet që do t'i përcillet Bashkisë, me kërkesën për të mos u pajisur me lejetë reja ndërtimi pa përfunduar procedurat e legalizimit për objektet tashmë të nisura prej tyre (134 subjekte). Në listën e dytë janë subjektet të cilat ju përgjigjen thirrjes sonë për bashkëpunim dhe u paraqitën për të vijuar procedurat e legalizimit për objektet e ndërtuara prej tyre, apo që u verifikuan për pozicionin e tyre në raport me këto ndërtime. I falënderojmë këto subjekte dhe shprehim gjithë disponicionin tonë për të përfunduar procedurat në të mirë të tyre dhe të banorëve të këtyre objekteve (122 subjekte). Në listën e tretë janë subjektet për të cilat kanë aplikuar banorët e këtyre objekteve në bazë të VKM 19/2017, ndërsa vetë subjektet ndërtuese nuk janë paraqitur. Mirëpresim edhe në vijim çdo informacion apo kontakt prej këtyre subjekteve për të vënë në proces legalizimin e këtyre objekteve (57 subjekte). Lista e katërt është ajo me subjekte të cilave AULUIZNI ju kërkon ndjesë për përfshirjen në listën e datës 30 maj.

Nr.	Emri i shoqërisë ndërtuese (sh.a/sh.p.k)
1	FONDACIONI "ZONJA E KESHILLIT TE MIRE"
2	SHOQATA "ARDHMERIA" SH.A
3	FONDACIONI "BAMIRESE" "NENE TEREZA"
4	VELLEZERIT KAJTAZI SH.P.K
5	ALBA KONSTRUKSION SH.P.K
6	2K GROUP SH.P.K
7	ERJONI SHPK
8	DREJTORIA E PERGJITHESHME E DOGANAVE
9	SHOQATA INTERNACIONALE PER SOLIDARITETIN, ERMIRA AZERMADHI

LISTA

- 1 I. Lista e subjekteve që do t'i përcillet Bashkisë, me kërkesën për të mos u pajisur me leje të reja ndërtimi pa përfunduar procedurat e legalizimit për objektet tashmë të nisura prej tyre**
- Nr.** **EMRI I SHOQËRISË NDËRTUESË (SH.A/SH.P.K)**
- HELIO KONSTRUKSION SH.P.K
 - INTER KONSTRUKSION SH.P.K
 - EA SH.P.K
 - NIADA PROJEKT SHPK
 - N.N.TIRANA SH.P.K
 - VASILI SH.P.K
 - EA SH.P.K
 - ARTUR SH.P.K
 - BINJAKET SHPK
 - GORA SH.P.K
 - BELHAUS SHPK-kalim të drejtash tek BJORN SHPK
 - BELHAUS SHPK
 - KUALITET 95 SH.P.K kalim të drejtash tek PELIVANI SHPK
 - KUALITET 95 SH.P.K
 - PEGASO SH.P.K
 - PALI SH.P.K
 - SHYZE SH.P.K
 - DANIJELA SH.P.K
 - INTERAS GROUP SH.P.K
 - BEST KONSTRUKSION ALB SHPK
 - JANO SHPK
 - ERRE. GI. ALBANIA SH.P.K
 - MIG MAR SHPK
 - GORA SH.P.K
 - LIVELADA SHPK MARSEL CONSTRUKSION SHPK
 - KONOMI SH.P.K
 - ALB-RNK SHPK
 - NIADA PROJEKT SHPK
 - ERORDA SH.P.K
 - ALB BUILDING SH.P.K
 - KRISTIAN CONSTRUCTION SH.P.K
 - DOLA SHPK
 - PREKLU SH.P.K
 - AD-STAR SH.P.K
 - TITAN KONSTRUKSION SHPK
 - A-A CONSTRUCTION SHPK
 - KRISTIAN CONSTRUCTION SH.P.K
 - 1961/2014
 - K&M CONSTRUCTION
 - TEDI KONSTRUKTION SHPK
 - KRISTIAN CONSTRUCTION SHPK
 - 4312/2015
 - TEKNO PROJEKT SHPK
 - RELI-KONSTRUKSION SHPK
 - GREEN KOSTRUKSION SHPK
 - ERALE SHPK
 - MEGI KONSTRUKSION SH.P.K
 - KONUDA SH.P.K
 - TOEM SHA
 - NILA SHPK
 - DRINI CONSTRUKSION SH.P.K.
 - KRISTI CO
 - KRISTI CO
 - HYSNELI
 - SIGERS
 - "PONARI CONSTRUCTION
 - KATALENA
 - ZYFER QANI DURO
 - SAMI ZYFER DURO
 - AGIM NASUFI
 - GAZMEND SHANI
 - ALI DYRMISHI
 - MEHMET LAMKO
 - ALBAN TIRANA SH.P.K

- 63** TRUST SH.P.K
- 64** BESA G-T SH.P.K
- 65** BUSA SH.P.K
- 66** S.N.D CONSTRUKTION
- 67** TIKHEJ SH.P.K
- 68** AGIBESHALLI SH.P.K
- 69** HYSA SH.P.K
- 70** JOLAND SH.P.K
- 71** TËUTA KONSTRUKSION SH.P.K
- 72** KLEANT MUSABELLIU
- 73** A-B SH.P.K
- 74** DINI 2009 SH.P.K
- 75** DOKA ROAL SH.P.K
- 76** ERILD SH.P.K
- 77** GU-AL-01 SH.P.K
- 78** JON SH.P.K
- 79** SHOGERIA TREBESHINA SH.P.K
- 80** DELTA ENGINEERING SH.P.K
- 81** FINANCIALLEGAL SOLUTION SH.P.K
- 82** REKORD SH.P.K
- 83** A LO SHPK
- 84** TIRANA DUE SH.P.K
- 85** ASK SH.P.K
- 86** G-P SH.P.K
- 87** NOKIT-O-S-2008 SH.P.K
- 88** MESAPLIK-05 SH.P.K
- 89** JORA SHPK
- 90** A&E ALBTUR SH.P.K
- 91** ITALCONSTRUZIONI PISTOIA SH.P.K
- 92** A&A KONSTRUKSION 2011 SH.P.K
- 93** LABA 99 SH.P.K
- 94** MËRGA SH.P.K
- 95** KOTORI-SL SH.P.K
- 96** AGOLLIS-A SH.P.K
- 97** ASK SH.P.K
- 98** BACI KONSTRUKSION SH.P.K
- 99** BEU-KONSTRUKSION SH.P.K
- 100** BTRAJ-98 SH.P.K
- 101** BUSA SH.P.K
- 102** DE&KLA-02 SH.P.K
- 103** GU-AL-01 SH.P.K
- 104** H.E.L.D.I. KONSTRUKTION SH.P.K
- 105** JON SH.P.K (GORA)
- 106** KLASS SH.P.K
- 107** KORA SH.P.K
- 108** KOTICA 2007 SH.P.K
- 109** LABA 99 SH.P.K
- 110** MARITUDA SH.P.K
- 111** MIKETA 2000 SH.P.K
- 112** RUCH SH.P.K
- 113** 3A GROUP SH.P.K
- 114** AGOLLIS&A-ULDEDAJ-LIS
- 115** KONFORT-KONSTRUKSION SH.P.K
- 116** L.N.K SH.P.K
- 117** REKORD SH.P.K
- 118** SAHTIA KONSTRUKSION SH.P.K
- 119** ALBA SH.P.K
- 120** GORA SH.P.K
- 121** HARMONIA SH.P.K
- 122** LORENA SH.P.K
- 123** MESAPLIK-05 SH.P.K
- 124** ELVIS SHPK
- 125** MARS1 SH.P.K
- 126** SANDY SH.P.K
- 127** PERPARIM AZIZZLARI
- 128** AL-POINT SHPK
- 129** SIGERS SHPK
- 130** ALBTEKNO STAR SHPK
- 131** EKNA ALBANIA SHPK
- 132** FAMA SHPK
- 133** LIKA SHPK
- 134** MESAPLIK-05 SH.P.K

- LISTA 2 II. Lista e subjekteve të cilat ju përgjigjen thirrjes sonë për bashkëpunim dhe u paraqiten për të vijuar procedurat e legalizimit për objektet e ndërtuara prej tyre, apo që u verifikuan për pozicionin e tyre në raport me këto ndërtime**
- Nr.** **Emri i Shoqërisë Ndërtuese i Banorë**
- Al Konstruksion Gbi Sh.P.K
 - Helio Konstruksion & Kristi Sh.P.K
 - Mico Sh.P.K
 - N.N. Tirana Sh.P.K
 - Niada Projekt Sh.P.K
 - Stier Sh.P.K
 - Vellezit Luzi Sh.P.K
 - Nako Sh.P.K
 - Ferrar Sh.P.K
 - Neda Sh.P.K
 - Mehmetali Mustafa Reka Pf
 - Filloreta Hajnaj
 - Indrit Banka
 - Patbarth Agim Kadili
 - Petrus Johannes Cornelis
 - Hamdi Faruka
 - Banoret Pa11.103/1
 - Agron Tafaj
 - Hatixhe Sadiku
 - Mamush Cano
 - Bujar Bici Eduard
 - Daka
 - Shpendi Sh.P.K
 - Sinani Sh.P.K
 - Dashnor Egereem Shena
 - Kico Kol Kutali
 - Rilindja Shpk
 - Manjola Toska Bilal Toska
 - Sh N P Sh.Sh.P.K
 - Al-De 2 Sh.P.K
 - Mab Edil Pmi Sh.P.K (Juvenilja 4)
 - Lumturi Sabri Hoxha
 - Esat Qamili Ismaili
 - Mahir Faiz Hallii
 - Memush Nelaj; Majlinda Bogdo; Mimoza Dragush Bogdo
 - Al Konstruksion Shpk
 - Ndërtues 10
 - Veli Ibrahim Serjani
 - Z. R Sh.P.K
 - Mir Borova Artallat 367
 - Banoret E Pallatit 367
 - Mibara Sh.P.K
 - Melrose Investment Group Sh.P.K
 - Edmond Taip Shaba
 - Hidda Projekt Sh.P.K
 - Valentina Frok Gjokaj
 - Banoret E Pallati 141/1
 - Albina Sh.P.K
 - Vigand Konstruksion Sh.P.K
 - Lelja Edip Shijaku
 - Viron Jorgag Cipi
 - Gjikuria Sh.P.K
 - Bashkim Haki Sejdo
 - Eduart Hyzen Hysa
 - Al-Mak Sh.P.K
 - Sh.N.P.Sh Sh.P.K
 - Arjan Allaman Cenalla
 - Asim Myftar Pregia
 - Fatos Mexhit Muraku

- 55** Drita Sula Kujtim Mehmet Sula
- 56** Dragush Zenel Prespa
- 57** Alba Konstruksion Sh.P.K
- 58** Mehmet Zeir Shehu
- 59** Xhakonda Sh.P.K
- 60** Duerre Konstruksion Sh.P.K
- 61** Alko - Impex Sh.P.K
- 62** Roda Shpk
- 63** Alb Milenium Shpk
- 64** Kolestro Sh.P.K
- 65** A.E Konstruksion Sh.P.K
- 66** Al - Mak Sh.P.K
- 67** Besa- R Sh.P.K
- 68** Ylli Azis Carcanji + Banoret
- 69** Petrit Vaska
- 70** Haxhivire Mehmet Zhegu (Brusha)
- 71** Bardhyl Demetaj
- 72** Proj-Invest Sh.P.K
- 73** Elpinqi Cajupi
- 74** Themeli Konstruksion Sh.P.K
- 75** Rilindja Sh.P.K
- 76** Erregi Albania
- 77** M-Construktori Shpk
- 78** Kalaj Sh.P.K
- 79** Jeg Sh.P.K
- 80** Konomi Sh.P.K
- 81** It-Al-Beton2
- 82** Lorin Sh.P.K
- 83** Popa Sh.P.K Max-97 Sh.P.K
- 84** A.A Shpk
- 85** Alban Tirana Co Shpk
- 86** Alban-Tirana Co Shpk
- 87** S.S.X Shpk
- 88** S.S.X Shpk
- 89** S.S.X Shpk
- 90** Gora Shpk
- 91** Birta Tirana Sh.A
- 92** Dardvil Sh.P.K
- 93** Honme-Shkodra
- 94** Frigo Alb
- 95** Laze Shpk
- 96** Shoqeria "II.P.Ih" Sh.A.
- 97** All Balkans Corporation Sha
- 98** All Balkans Corporation Sha
- 99** All Balkans Corporation Sha
- 100** All Balkans Corporation Sha
- 101** Mareg Sh.P.K
- 102** Ferla Group Shpk
- 103** Universal Sh.P.K Gjok Nika
- 104** A.E.T Shpk
- 105** Bimo Shpk
- 106** Afc Shpk
- 107** Afc Shpk
- 108** Kombinati I Mishit (Kmy) Sh.A
- 109** Bad Shpk
- 110** Bad Shpk
- 111** Lulljana + P.Th., V.H., P.S., T.K.
- 112** Fondaci "Ins.Inkur>Total"
- 113** Saturn Construction Shpk
- 114** Shoqeria "Sidrit&Xhemi"
- 115** Shoqeria "Sidrit&Xhemi"
- 116** Edoni Konstruksion Shpk
- 117** Pnevnis Shpk.
- 118** Shaga Shpk
- 119** H&E Shpk
- 120** Zaimaj Shpk
- 121** Mig&Kte Shpk
- 122** Balcan Zoo Farm-2014 Shpk

- LISTA 3 III. Lista e subjekteve për të cilat kanë aplikuar banorët e këtyre objekteve në bazë të VIVA 191/2017, ndërsa vetë subjektet ndërtuese nuk janë paraqitur.**
- Nr.** **EMRI I SHOQËRISË NDËRTUESË (SH.A/SH.P.K) - vetedeklaruar nga banorët**
- ZAIMAJ
 - KOMFORT
 - ERREGI
 - GLAVENICA
 - BASHKI MI
 - VRINA- CO
 - ALBA- FLOR
 - CMETA
 - MIRI KONSTRUKSION
 - C.M.A ALBANIA
 - GIRON
 - ELSIDI SH.P.K
 - BIMO
 - PEZA SH.P.K
 - PINARI SH.P.K
 - MANO SH.P.K
 - G.KAM SH.P.K
 - TREG TRANS HYSA
 - LESKA/ AGI-ARM/NIADA PROJEKT
 - PEZA SH.P.K
 - B.E.E.M- 1
 - SYRI KALTER
 - REAL NDERTIMI PROJEKTIM
 - BLERO
 - ERIDES 55
 - PROTAL
 - Z. P. Z VEPRA NDERTIMORE
 - SCUTARI CONSTRATION
 - AGI BES HALILI
 - AGI BES HALILI
 - A-A KONSTRUKSION
 - ARENS
 - AL-MAK
 - ALSTON
 - DOLA
 - DOLA
 - DOLA
 - ALBANBERT
 - KVCHA CONSTRUCTION
 - KIRCHBERGER ALBANIA
 - KATER GRKYET
 - SHERON
 - STAR CONSTRUCTION
 - SHKRELL
 - REKHEPI
 - RIVIERA
 - EDAL
 - VILA PARK - ALB
 - VILA PARK - ALB
 - VILA PARK - ALB
 - VILA PARK - ALB
 - VILA PARK - ALB
 - INA
 - INA
 - CANI
 - KRISTIAN CONSTRUCTION

Shkak, konflikti për biznesin mes viktimës dhe agresorëve

Vlorë, ekzekutimi i biznesmenit Vasil Dervishaj, identifikohen dy autorët

Përfundojnë në pranga dy bashkëpunëtorët

VLORE

Dy ditë pas vrasjes me plumb në kokë të biznesmenit Vasil Dervishaj, policia e Vlorës ka zbardhur ngjarjen e rëndë që tronditi qytetin bregdetar. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Këtij qarku dhe bënë me dije se janë identifikuar dy autorët e krimit. Bëhet fjalë për shtetasit me inicialet E.A., 31 vjeç dhe A.C., 28 vjeç, të dy lindur në Tepelenë dhe banues në Vlorë. Ndërkohë që kanë përfunduar në pranga dy bashkëpunëtorët. Të arrestuarit janë: Nekid Arapi, 21 vjeç dhe Amarildo Grembi (Muka), 28 vjeç, të dy banues në Vlorë. Sipas bluve, këta dy të fundit kanë përkrahur vrasësit e 29-vjeçarit Dervishaj pas ngjarjes së ndodhur rreth orës 23:00 të së hënës tek ish-Kombinatit i Peshkut, në lagjen "Pavarësia". Vasil Dervishaj, baba i një femije të mitur u qëllua për vdekje me pistoletë teksa ishte duke udhëtuar me automjetin e tij tip "Ford" me targa italiane "OD 476 AF". Sipas hetuesve të çështjes, ngjarja ka ardhur si rrjedhojë e një konflikti që viktima ka pasur kohët e fundit me dy autorët e dyshuar E.A. dhe A.C. në lidhje me biznesin e tij.

DINAMIKA E NGJARJES

Policia e Vlorës dhe deklaroj se vrasja me armë zjarri e 29-vjeçarit Vasil Dervishaj është zbardhur në kohë rekord, falë bashkëpunimit të ngushtë me prokurorinë e rrethit. Të njëjtat burime thanë se kanë zhvilluar hetime intensive me qëllim zbardhjen, dokumentimin e plotë të rrethanave të ngjarjes dhe kapjen e vënien para drejtësisë të autorëve të krimit. Në fakt, blutë mundën të vënë në pranga vetëm bashkëpunëtorët dhe jo vrasësit. "Si rezultat i një punë të mirëorganizuar është bërë e mundur zbardhja në kohë rekord e ngjarjes, identifikimi i autorëve, të cilët janë shpallur në kërkim si dhe kapja e arrestimi i shtetasve të cilët kanë përkrahur autorët e krimit pas ngjarjes", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Ndërkaq, grupi hetimor ka sekuestruar në



Biznesmeni i vrarë, Vasil Dervishaj

cilësinë e provës materiale: një kallashnikov model 56, me një krehër me fishekë, një gëzhojë armë zjarri, model 9mm; një pjesë predhe armë zjarri e demtuar si dhe një automjet tip "Audi", me të cilin dyshohet se janë larguar autorët pasi kanë kryer krimin. Mësohet se shtetasi

E.A., dhe A.C. akuzohen për veprat penale "Vrasje me pararendim e kryer në bashkëpunim" dhe "Mbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarake". Ndërsa, dy të arrestuarit Nekid Arapi dhe Amarildo Grembi akuzohen për veprën penale "Përkrahja e autorit të krimit".

Merrnin 10 deri në 16 mijë euro për të dërguar shqiptarët në Angli, kapen 2 organizatorët e rrejtit

ELBASAN - Policia e Elbasanit ka goditur një aktivitet kriminal në fushën e falsifikimit të dokumenteve dhe ndihmës për kalim të paligjshëm të kufijve kundrejt fitimit. Pas një hetimi disamujor me metoda speciale të hetimit janë vënë në pranga dy organizatorët e rrejtit, që pajisnin me dokumente false shqiptarët për t'i dërguar më pas drejt Anglisë e Gjermanisë. Sipas bluve, gjatë operacionit të koduar "Premtimi" janë arrestuar shtetasit Musa Rama, 60 vjeç, lindur në Librazhd dhe banues në Tiranë (i dënuar më parë) si Arben Hako, 51 vjeç, lindur dhe banues në lagjen nr.1, Durrës (i dënuar më parë). Mësohet se këta persona në bashkëpunim me njëri-tjetrin kryenin këtë aktivitet kriminal prej disa kohësh në territorin e Shqipërisë, kundrejt përfitimit ku mundësonin dërgimin e shtetasve të ndryshëm në drejtim të Anglisë, Gjermanisë e vendeve të tjera të Europës, duke e bërë të mundur me falsifikimin e dokumenteve dhe përdorimin e formave dhe metodave të tjera. Kjo, përkundrejt shumave me vlerë nga 10 mijë deri në 16 mijë euro për person. Nga kontrolli i banesave të Ramës dhe Hakos janë sekuestruar në cilësinë e provave materiale: një automjet me targa AA 630 OD, shtatë telefona celularë, 14 pasaporta biometrike të shtetasve të ndryshëm, 80 copë dokumente në gjuhën shqipe dhe gjermane, 35 copë certifikata personale dhe familjare shtetasish të ndryshëm si dhe 13 copë certifikata shkolle dhe trajnimesh dhe një sasi parash prej 850 euro. Ndërkaq, vijnë hetimet edhe për persona të tjerë të përfshirë në këtë aktivitet kriminal.

REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST (CONSULTING COMPANY)

ALBANIA
CITIZEN - CENTRIC SERVICE DELIVERY PROJECT
Loan Agreement Project ID No. 8521

Posted 07.06.2018

Assignment Title: **Conducting the Midterm Assessment - Household Survey**

Ref. No: **ALB-8521/CS/CQ/3.11.01**

Under the Innovative Good Governance priority, launched in April 2014, the Program "Innovation against Corruption: Building a Citizen Centric Service Delivery Model in Albania continues under the supervision of the Deputy Prime Minister's Office. The program entails a multilayered reform that focuses on key administrative central government public services to reduce the time and burden for citizens and businesses and improve service delivery quality, transparency and efficiency by using innovative solutions and information technologies. Its key pillars are (i) the establishment and management of an integrated nationwide model of service delivery whereby, the front office is focused on the relation with the public and is separated from back office processing, including the implementation of the one-stop-shop and in-one-place approach of the Citizen Service Center; (ii) service provision standardization, simplification through business process re-engineering and digitization, with a focus on online services; and (iii) citizen feedback and performance monitoring on service delivery for ongoing improvement.

ADISA has taken several steps by first standardizing the information on public services and making such information available in multiple platforms, both digital and non-digital in order to reach all population categories. Such platforms include a dedicated line 118 00 (Call Center service), operational for inbound calls since October 2016, the One Stop Shop Centers where a dedicated desk is set for providing information to anyone who visit them, the e-Albania portal and ADISA's website.

A baseline assessment survey was conducted in the first half of 2016, producing baseline data on several indicators, in order to measure progress toward project's objectives.

As part of the effort to monitor the effectiveness of these interventions, ADISA is seeking the services of a firm/Consultant to conduct a midterm assessment to measure project progress. It consists of conducting a nationally representative household survey, intended to yield data on citizen access to public services, citizen satisfaction with public services, use of e-government, and channels for service delivery and information, etc. The information collected through the HH survey will supply data on specific project indicators regarding Access to administrative services in Albania, particularly the access to services of the vulnerable groups (including Roma), poor, female, etc..

The Project Management Unit now invite eligible "Consultant" to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services.

The Consultant shall possess and be able to prove the following qualifications, experience, skills and competencies:

- No less than 10 (ten) years of general experience in surveying is required, with special reference to nationwide household surveys.
- At least 2 similar contracts successfully carried out within the last 5 (five) years with certificates of satisfaction issued by the employers.
- Key staff with necessary qualifications and experience to run and manage and the assigned tasks. These include:
 - Team Leader, who plans, supervises and manages the entire assignment, both the HH survey, with the assistance of the field and data managers and data analysts. S/he is responsible for the reporting to the beneficiary. Requirements comprise at least ten years of experience in managing and conducting related development assessment surveys, evaluations, and field research, including significant experience conducting large-scale, complex, mixed-method studies, data analyses, and producing high quality written reports. Should possess degree in management, economics, or other relevant field, and specific training/experience in survey management and data analysis.
 - 1 Project coordinator, responsible for daily coordination and management of project activities, resources, equipment and information. He/she is the liaison between the team leader and the rest of the staff. Project coordinator must possess demonstrated experience as project coordinator, with proven experience in managing large scale quantitative surveys. Should possess degree in management, economics, or other relevant field, and specific training/experience in survey management.
 - 3 Field Managers responsible for training of field staff in charge for carrying out the face to face household assessment, which plan, supervise and manage the field work. The Field Managers must have experience in managing field work of large-scale household surveys of over 1000 households; have degree in management, or other relevant field, and specific training in survey management. They must be familiar with the use of the CAPI.
 - 1 Data Analysts/manager, who plans, supervises and manages data entry, error checking, processing and consolidation of data; has solid skills in both quantitative and qualitative analysis including professional and frequent application of quantitative analysis software such as SPSS, STATA, or equivalent applications. The data analyst/manager must have experience in managing data entry of large-scale household surveys of over 1000 households; degree in statistics or other relevant discipline; specific training in household survey management and data analysis, and specific training and experience in using CAPI.

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's Guidelines: Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers (January 2011 edition, revised July 2014) ("Consultant Guidelines"), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

The Consultant will be selected in accordance with Consultant Qualifications method set out in the Consultant Guidelines.

Further information can be obtained at the address below during office hours from 08:00 to 16:00, Mondays to Thursdays, and from 08:00 to 14:00 on Fridays

The notification is posted on the website of the Agency for the Delivery of Integrated Services in Albania (ADISA): www.adisa.gov.al.

Expressions of interest (CVs, Letter of Interest and documentary evidence for fulfilling the qualifications) must be delivered in a written form to the address below in person, or by mail, or by e-mail by **June 21, 2018, at 12.00 local time**

Project Management Unit
Blvd: Zhan d'Ark,
Ish shtëpia e oficerave, Kati V-të
Tirana, Albania
E-mail: roland.larashi@inovacioni.gov.al;
and ccsdprojectalbania@gmail.com

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) ka zhvilluar seancën e dytë për vlerësimin e vendimit të KPK nëse ish-kryetari i organit të akuzës, Adriatik Llalla, do t'i nënshtrohet ose jo procesit të vetingut. Komisioneri Publik, Florian Ballhysa tha se Adriatik Llalla si magjistrat nuk ka ndjekur procedurën ligjore të dorëheqjes. Ballhysa tha se megjithëse Llalla ka lënë detyrën në dhjetorin e vitit të kaluar, ai nuk është larguar si magjistrat dhe si i tillë, duhet të kalojë në filtrat e verifikimit të pasurisë dhe figurës. "Llalla e gëzon ende statusin e magjistratit për shkak se është ish-kryeprokuror. Ai nuk e ka

Komisioneri: Nuk janë ndjekur procedurat ligjore të dorëheqjes

Beteja e Adriatik Llallës për vetingun, avokati: Ish-kryeprokurori u hapi rrugë të tjerëve

AVOKATI

Avokati Sokol Hazizaj tha se klientit të tij, ish-kryeprokurorit Adriatik Llalla i kishte mbaruar mandati i kryeprokurorit, ndërsa shtoi faktin se nëse ai jep dorëheqje nga sistemi i drejtësisë, rivlerësimi ndërpritet.

dhënë dorëheqjen në formën e kërkuar", - tha Ballhysa. Ndërkohë, ish-kryeprokurori Adriatik Llalla nuk mori pjesë në seancë dhe u përfaqësua nga avokati Sokol Hazizaj, i cili tha se klientit të tij i kishte mbaruar

mandati i kryeprokurorit, ndërsa shtoi faktin se nëse ai jep dorëheqje nga sistemi i drejtësisë, rivlerësimi ndërpritet. "Është provuar se subjekti i rivlerësimit Llalla ka ushtruar mandatin e plotë të Prokurorit

të Përgjithshëm, pra nuk është si rastet e shkarkimit. Ka përfunduar mandatin që ia dha Kuvendi i Shqipërisë dhe për shkak të dispozitave, përfundoi mandatin. Jo vetëm kaq, por ligjëbërsi besoi tek ai, ndaj e konstatoi elementin korruptiv edhe u dha mundësi njerëzve jo për t'u dorëhequr nga analiza e korrupsionit, por për të respektuar të drejtën themelore të tij. Ne nuk kemi ardhur të mbrohemi nga fajësia. Jo për të



Adriatik Llalla

kundërshtuar komisionerin, por për të mbrojtur një shtetas që ka konsumuar në kohë të plotë mandatin. Ai e ka ushtruar këtë mandat. Në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet. Çfarë ka bërë subjekti Llalla? Ka hequr dorë nga drejta për

t'u kthyer në detyrën e mëparshme, si dhe nga çdo drejtë tjetër", pohoi avokati. Pas dëgjimit të palëve, Komisioneri Publik, Florian Ballhysa tha se vendimi përfundimtar për Adriatik Llallën do jepet të hënën, në 11 qershor, në orën 13:00.

Intervistë/ Aleks Hajdari: Krimi në Shqipëri është në duart e ministrisë

Policët në lirim, në protestë: Të goditen grupet e mirëfillta kriminale

Kreu i shoqatës: Fatmir Xhafaj të kalojë procesin e vetingut

Ina Allkanjari

Policët në lirim kanë zhvilluar ditën e djeshme një protestë para Ministrisë së Brendshme, duke kërkuar largimin e ministrit Fatmir Xhafaj. Ish-kreu i policisë, Aleks Hajdari, njëkohësisht kryetar i Shoqatës së Policëve në Lirim 2013, në një intervistë për "Gazeta Shqiptare" theksoi se krimi në Shqipëri është në duart e ministrisë, pasi sipas tij, dy ministra kanë lidhje me drogën. "Protestuam kundër fenomenit më të pashembullt që ka parë historia e Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit në këto 27 vite demokraci dhe ndoshta i vetmi vend në botë që kemi shkruar historinë me udhëheqjen e Ministrisë së Brendshme nga ministra nën akuzë për trafik ndërkombëtar droge, lidhje të forta me krimin e organizuar, me familjarë të afërt të dënuar për trafik ndërkombëtar të lëndëve narkotike", u shpreh kreu i shoqatës, Aleks Hajdari.



Kreu i shoqatës së policëve në lirim, Aleks Hajdari

të njëjtat kushte në të cilat ndodhet ministri i Brendshëm, ndërkohë që ky i fundit vazhdon pa problem detyrën? Protestuam kundër fenomenit më të pashembullt që ka parë historia e Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit në këto 27 vite demokraci.

Si mendoni, ku konsistojnë shkeljet e bëra nga drejtuesit e policisë?

Këta drejtues policie zbatuan projektin qeveritar

nën kujdesin e ministrit të Brendshëm për canabizimin e të gjithë territorit të vendit. Liruan pikat kufitare duke favorizuar trafikun e lëndëve narkotike drejt vendeve të BE-së kundrejt 30%, duke inkriminuar strukturën e Policisë së Shtetit në nivelet më të larta drejtuese të saj. Për herë të parë, grupe të strukturuar kriminale u bënë vendimmarrëse në emërime dhe në funksionim të Policisë së

Shtetit. Që të dy ministrat e kësaj qeverie ndodhen nën akuzë për implikim dhe lidhje me grupe dhe organizata kriminale, që kanë aktivitet për kultivim dhe trafikim të lëndëve narkotike.

Kush janë efektivet që u larguan nga detyra?

Këta larguan punonjësit e policisë më të arrirë profesionalisht, me përkushtim të lartë ndaj detyrës. Rikthyen persona të larguar me parë për shkelje ligjore, lidhje me krimin apo shpërdorim detyre. Nuk u mjaftuan me rikthimin e tyre në Policinë e Shtetit, por i emëruan në poste të larta drejtuese. Kjo protestë u organizuar për të gjitha lirimet nga detyra në shkelje flagrante të ligjit.

Cilat janë kërkesat e shoqatës që ju drejtoni?

Kërkojmë që ministri i Brendshëm t'i nënshtrohet procesit të vetingut si të gjithë që duhet ta kalojnë këtë proces. Gjithashtu, kërkojmë pastrimin e organizatës së policisë nga të inkriminuarit dhe rikthimin e saj në detyrat funksionale me të cilat e ngarkon ligji.

Si do reagoni nëse kërkesat tuaja nuk plotësohen?

Ne do përshkallëzojmë protestat, nëse kërkesat tona nuk merren parasysh. Askush nuk e beson që nuk ka më asnjë rrënjë kanabisi në vendin tonë. Policia nuk ka goditur grupe të mirëfillta kriminale, siç thotë Xhafaj.



Përdhanoi minorenë, u la në burg për 4.8 vite

Shoqëria civile, në protestë: Dënim më të rëndë për Ligor Bibën

Një tjetër protestë është regjistruar ditën e djeshme në Tiranë. Rrjeti kombëtar "Vepra për Fëmijët", përmes një tubimi para Kuvendit të Shqipërisë kundërshtoi vendimin e gjykatës së Korçës për vendimin që dha për përdhunuesin e 15-vjeçarës nga fqinjja i saj 54-vjeçar, Ligor Biba. Sipas protestuesve, vendimi në fjalë ku Biba u dënua me 4.8 vite burg është i padrejtë dhe ai duhet të rishikohet. Gjykata e Korçës dënoi me 4 vjet e 8 muaj burg Ligor Bibën, 55-vjeçarin që përdhanoi dhe la shtatzënë fqinjën e tij, atëherë 15 vjeçe. Ngjarja u denoncua publikisht në tetor të vitit 2017 dhe Biba përfundoi në pranga. Prokuroria e Korçës kishte kërkuar 8 vite burg për Bibën, i cili fillimisht mohoi akuzat, por analizat e ADN-së provuan atësinë e foshnjës së ardhur në jetë, ndaj ai ndërrori dëshminë në gjykatë duke pranuar fajësinë, por sërish ngulmoi se nuk bëhej fjalë për përdhunim. Pas shqyrtimit të çështjes, gjykata e Korçës e dënoi 55-vjeçarin Biba me 7 vjet burg, por ai përfitoi ulje 1/3 e dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar. Dhe përfundimisht do të vuajë 4 vjet e tetë muaj burg. 15-vjeçarja e abuzuar e ka lënë fëmijën e ardhur në jetë në Shtëpinë e Foshnjës në Tiranë, ndërsa gjatë muajve të procesit gjyqësor ndaj 55-vjeçarit, familja e saj në fshatin e Pogradecit ka denoncuar shpeshherë në media, presione të pretenduara nga ana e familjes së Ligor Bibës.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURIA NR. 8/58 + 1 - 4, E LLOJIT 'APARTAMENT', VOLUMI 3, FAQJE 188, ZONA KADASTRALE 8370, ME SIPERFAQJE 75 M2. NË ADRESËN: RRUGA 'TH.ZIKO, PALLATI 65/3, TIRANË, NË PRONËSI TË SHTETASVE : Z. ENZGJELL TOPORE DHE ZNJ. NATASHA TOPORE".

ÇMIMI 36.350 Euro . Data e zhvillimit të ankandit do jetë **04.06.2018 deri në datën 04.07.2018 .**

CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

LUFTA ANTIKANABIS VENDIMI

Fletorja Zyrtare, Këshilli i Ministrave: Të identifikohen sipërfaqet e mbjella me kanabis

Miratohet Plan i Veprimit kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit

"Bashkëpunim ndërinstytucional për parandalimin e trafikut të drogës"

Ina Allkanjari

Vizioni për një Shqipëri të çliruar nga bimët narkotike, ku dinjteti, mirëqenia dhe siguria e qytetarëve bazohen te puna e ndershme dhe respekti ndaj ligjit ka sjellë miratimin e planit antikanabis. Me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave miratoi ditën e djeshme Planin e Veprimit kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit 2017-2020. Hartimi i këtij plani Kombëtar kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit (PKKK) është diktuar nga nevoja për të parandaluar, goditur dhe shkatërruar dukurinë e kultivimit, trafikimit dhe përdorimit të kanabisit. "Nëpërmjet këtij plani, qeveria shqiptare, parashikon bashkëpunim ndërinstytucional, ndërkombëtar dhe koordinim në ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme, duke angazhuar të gjitha burimet e nevojshme njerëzore, materiale dhe financiare për parandalimin dhe shkatërrimin e kultivimit, trafikimit dhe përdorimit të kanabisit në vend", thuhet në Fletoren Zyrtare. Qëllimi i këtij plani është identifikimi i sipërfaqeve të mbjella me kanabis dhe atyre potenciale për t'u mbjellë si dhe goditja e shkatërrimi i rrjetëve të kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike.

SHKATËRRIMI I RRJETEVE TË TRAFIKIMIT

Goditja e vendosur dhe shkatërrimi i rrjeteve kriminale, të përfshira në trafikimin e lëndëve narkotike është objektivi më i rëndësishëm strategjik i këtij plani. Ky objektivi përbën gurin themeltar të luftës kundër kanabisit. Përmbytja me sukses e tij ndikon në përmbytjen me sukses



Foto ilustruese

VEPRAT PENALE


Kodi Penal klasifikon si veprë penale dhe parashikon dënim për prodhimin, kultivimin dhe shitjen e narkotikëve, nxitjen/promovimin e prodhimit dhe konsumimin e lëndëve narkotike, mbajtjen apo prodhimin e substancave të ndryshme kimike që janë bazë apo mund të përdoren për prodhimin e lëndëve të ndryshme kimike si dhe përshtatjen e ambienteve për përdorimin e narkotikëve.

dhe të objektivave të tjerë. Nëpërmjet tij synohet që të shtohen dhe identifikohen masat shtrënguese dhe goditëse ligjore nga të gjitha drejtësit dhe në të gjitha nivelet. Objektiva specifike për goditjen dhe shkatërrimin e trafikimit janë: rritja e vigjilencës dhe shtimi i kapaciteteve të strukturave doganore, tatimore dhe të inteligjencës financiare për një kontroll më rigoroz për parandalimin e trafikimit të lëndëve narkotike. Bashkëpunimi i hershëm i shërbimeve inteligjente dhe policore me strukturat homologe të vendeve të origjinës së farërave; përmirësimi dhe intensifikimi i kontrollit kufitar nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit të strukturave përgjegjëse për kufirin, shtimi i kapaciteteve të skanimit, rishikimi të kriterëve të përcaktimit të risikut dhe kontrollit elektronik e fizik; përmirësimi i procedurave për kontrollin e qarkullimit të parasë në pikat kufitare; vlerësimi ndërinstytucional i risikut

për mjetet e transportit në pikat kufitare, nëpërmjet përfshirjes në këtë proces të të gjithë aktorëve shtetërorë përgjegjës. Përfshirja e strukturave doganore, tatimore, policore, bujqësore, mjedisore dhe atyre të inteligjencës në vlerësimin e risikut në transportin tokësor, detar dhe ajror ndërkombëtar, si dhe shtimi i konsiderueshëm i kapaciteteve dhe i frekuencës së kontrolleve fizike dhe skanimit; rritja e kapaciteteve operacionale njerëzore, logjistike dhe financiare i të gjitha strukturave qendrore dhe vendore të angazhuara kundër kultivimit, përdorimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike; shtimi i kapaciteteve njerëzore të strukturave të ngarkuara me kontrollin e territorit, nëpërmjet përforcimit dhe mbështetjes së kapaciteteve policore edhe nga strukturat ushtarake, të angazhuara në kontrollin e territorit në përputhje me përcaktimet përkatëse ligjore; rrit-

PLANI I VEPRIMIT

"Nëpërmjet këtij plani, qeveria shqiptare parashikon bashkëpunim ndërinstytucional dhe ndërkombëtar dhe koordinim në ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme, në shkatërrimin e kultivimit, trafikimit dhe përdorimit të kanabisit në vend", thuhet në Fletoren Zyrtare.



ja e kapaciteteve teknike të Policisë së Shtetit dhe strukturave të tjera kryesisht me automjete të kalueshmërisë së lartë, mjete zbulimi në distanca të largëta për ditën dhe natën etj. Gjithashtu, PKKK-ja mban në konsideratë faktorët bazë që nxisin kultivimin dhe trafikimin e lëndëve narkotike në vend, ndër të cilët mund të përmendim kushtet ende të vështira social-ekonomike, kërkesën ndërkombëtare përherë në rritje, zbatimin e standardeve të ndryshme ligjore në vendet e destinacionit për konsumin e drogës, bashkëpunimin e ngushtë të rrjeteve kriminale në vend me rrjetet kriminale të Bashkimit Evropian, si dhe fuqinë financiare dhe fleksibilitetin për t'u adaptuar këtyre grupeve. Theksi kryesor i PKKK-së është përpjekja e përbashkët ndërinstytucionale për goditjen e gjithanshme dhe frontale me qëllim identifikimin, zbulimin dhe shkatërrimin e grupeve dhe rrjeteve kriminale që janë aktive në fushën e kultivimit dhe trafikimit të kanabisit dhe jo vetëm. Një tjetër risi e rëndësishme e PKKK-së është mënyra se si matet suksesi i institucioneve dhe strukturave të ngarkuara me parandalimin dhe goditjen e fenomenit të kultivimit dhe përdorimit të kanabisit në vend. Indikatorët kryesorë matin kryesisht suksesin në identifikimin, zbulimin, ndalimin dhe vënien përpara drejtësisë të finan-

cuesve dhe drejtuesve të grupeve dhe rrjeteve kriminale. Në ndryshim nga qasjet e mëparshme strategjike dhe praktika e ndjekur nga organet ligjzbatuese, PKKK-ja e orienton përpjekjen e institucioneve në fazat e hershme të ciklit të kultivimit të kanabisit, duke synuar që suksesi të arrihet duke parandaluar futjen e

mbjellura, në sipërfaqe relativisht të vogla dhe kryesisht pranë zonave të banuara. Identifikimi dhe sekuestri i aseteve të krijuara nga veprimtaritë kriminale është një tjetër kriter i rëndësishëm për të matur shkallën e suksesit në përbaljen me fenomenin e kanabisit. Kujtojmë se Shqipëria ka një kuadër të gjerë dhe të plotë ligjor dhe nënligjor, si dhe një bazë të konsiderueshme dokumentesh strategjike që adresojnë çështjet e lëndëve narkotike. Një nga prioritetet kryesore në programin e qeverisë shqiptare dhe Ministrisë së Brendshme është lufta kundër kultivimit të bimëve narkotike, trafikut të drogave dhe krimin të organizuar. Kodi Penal klasifikon si veprë penale dhe parashikon dënim për: i) prodhimin, kultivimin dhe shitjen e narkotikëve; ii) nxitjen/promovimin e prodhimit dhe konsumimin e lëndëve narkotike; iii) mbajtjen apo prodhimin e substancave të ndryshme kimike që janë bazë apo mund të përdoren për prodhimin e lëndëve të ndryshme kimike si dhe iv) përshtatjen e ambienteve për përdorimin e narkotikëve. Gjithashtu, në kuadër të luftës kundër kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike janë miratuar konventa, ligje specifike, akte nënligjore, si dhe janë hartuar dokumente strategjike e programe, duke krijuar bazën e nevojshme rregullatore.

Objektivat kryesorë të PKKK-së janë: parandalimi dhe reduktimi i kultivimit, goditja dhe shkatërrimi i rrjeteve të trafikimit, reduktimi dhe shkurajimi i përdorimit të kanabisit, bashkëpunimi, koordinimi dhe forcimi i kapaciteteve, si dhe ndërgjegjësimi i publikut dhe zhvillimi i projekteve.

farërave në vend dhe duke goditur bimët në fazën kur ato janë fidanë, në mjedis të



Foto ilustruese

2.5 MILIONË BIMË KANABIS


Në vitin 2015 u identifikuan dhe asgjësuar 797.422 bimë kanabis të kultivuara, kurse në vitin 2016 rezultojnë të identifikuar dhe të asgjësuar 2.534.120 bimë kanabis, numri më i lartë i bimëve të asgjësuar në historinë e shtetit shqiptar, mbi 3 herë më i lartë krahasuar me totalin e bimëve të asgjësuar në vitin 2015.

Tabella 1. Rezultatet në luftën kundër trafikimit të lëndëve narkotike në vitet 2006-2016, numri dhe në peshë

Vitet	Rastet e kapura	Sasia e kanabisit, marupit, hashashit si substancat si substancat	Sasia e vëllit të hashashit si substancat	Autorët që proceduar penalisht
2006	199	6754 kg 207.1 g	0.95 tona	300
2007	121	7100 kg 608.6 g	-	199
2008	191	3941 kg 313.3 g	-	286
2009	232	3424 kg 479.4 g	9.5 ml	314
2010	389	7204 kg 805.6 g	-	559
2011	507	7695 kg 658.6 g	-	739
2012	823	+32 kg 210.3 g hashash 21136 kg 231.4 g +5 kg 112.2 g hashash	1 kg 584.2 g	1056
2013	1056	20672 kg 916.9 g	500 g	1147
2014	1096	+32 kg 480.2 g hashash 97226 kg 861.9 g	359 ml	1328
2015	903	+24 kg 450 g hashash 11 tone 352 kg 829 g +60 kg 16 g hashash	11 kg 154.4 g	1301
2016	1314	50 tone 614 kg 791.0 g	5 tona 818 ml	1739


Rezultatet në luftën kundër trafikimit të lëndëve narkotike në vitet 2006-2016

Grafika 1. Totali i bimëve narkotike të identifikuar/ asgjësuar gjat periudhës 1999-2016



Totali i bimëve narkotike të asgjësuar në periudhën 1995-2016

Grafika 2. Numri i autorëve të proceduar penalisht për trafikim narkotik, për periudhën 2006-2016



Numri i autorëve të proceduar penalisht për kultivim narkotikësh për periudhën 2009-2016

1.826 autorë të proceduar penalisht gjatë periudhës 2006-2016. Ja si operojnë grupet kriminale

Historia e fenomenit të kanabisit në Shqipëri që nga viti 1990

Rreth 6.944.092 bimë narkotike të asgjësuar për një periudhë 21-vjeçare

Ina Allkanjari

Kultivimi dhe trafikuimi i kanabisit në Shqipëri e ka zanafillën në fillim të viteve 1990, fillimisht duke u kultivuar në zonat Sarandë, Delvinë dhe Gjirokastrë dhe gjatë viteve 1995-1996 në të gjitha qarqet e vendit. Kështu, gjatë vitit 1995 janë identifikuar dhe asgjësuar nga strukturat e Policisë së Shtetit 167.417 bimë narkotike dhe në vitin 1996 janë identifikuar/asgjësuar 383.968 bimë narkotike ose 2.2 herë më shumë se gjatë vitit 1995. Si rezultat i kësaj veprimtarie, filloi edhe trafikuimi brenda dhe jashtë vendit i lëndëve narkotike kryesisht në Itali, Greqi, si dhe në vende të tjera. Praktika e kultivimit dhe trafikimit të kanabisit u intensifikua gjatë dhe pas vitit 1997, si pasojë e mosfunksionimit të institucioneve shtetërore, kryesisht atyre të sigurisë e të integritetit. Numri i bimëve narkotike të identifikuar dhe asgjësuar në veçanti gjatë periudhës 1997-2013 nuk është plotësisht i saktë për shkak se për këtë periudhë, strukturat e Policisë së Shtetit nuk kanë mundur të realizojnë ndërhyrje të plota në zonën e Lazaratit për asgjësimin e bimëve narkotike të kultivuara. Referuar raporteve të Guardia Di Finanza, nga monitorimi ajror i kryer me avionet speciale në vitin 2012 dhe 2013 mbi zonën e Lazaratit është konstatuar se në këtë zonë janë kultivuar përkatësisht 383 ha në vitin 2012 dhe 319 ha në vitin 2013. Deri në vitin 2014, qendra kryesore të prodhimit të nënprodukteve të kanabisit ishin Lazarati në jug dhe Dukagjini në veri të vendit. Në mes të vitit 2014, dy operacione shumë të suksesshme policore janë kryer në këto dy zona dhe si pasojë u shkatërruan një numër shumë i madh i bimëve të kanabisit dhe një sasi e madhe e marijuanës.



Numri i procedimeve penale në fushën e narkotikëve

zonave nën kontroll të vazhdueshëm, ndikoi në rritje të çmimit të kanabisit, si rrjedhojë e mungesës së// dhe zhvendosje të aktivitetit të grupeve kriminale në zona të tjera në të gjithë territorin, duke u reflektuar në rritjen e numrit të bimëve narkotike të kultivuara gjatë viteve 2015 dhe 2016. Në vitin 2015, u identifikuan dhe asgjësuan 797.422 bimë kanabis të kultivuara, kurse në vitin 2016 rezultojnë të identifikuar dhe të asgjësuar 2.534.120 bimë kanabis, numri më i lartë i bimëve të asgjësuar në historinë e shtetit shqiptar, mbi 3 herë më i lartë krahasuar me totalin e bimëve të asgjësuar në vitin 2015. Për periudhën 1995-2016 janë identifikuar/asgjësuar gjithsej 6.944.092 bimë narkotike ose mesatarisht 289.337 bimë narkotike në çdo vit. Ndërkohë, për gjatë periudhës 2006-2016, në lidhje me këto sasi të identifikuar dhe asgjësuar janë proceduar penalisht 1.826 autorë në total. Pavarësisht se ndër vite është rritur numri i rasteve dhe individëve të proceduar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për veprat penale që lidhen me narkotikët, numri i rasteve të evidentuara dhe autorëve të identifikuar për vepra penale që lidhen me narkotikët të kryera në formën e organizatave kriminale mbetet kryesisht i ulët.

GRUPET KRIMINALE

Vlen të theksohet se konteksti në të cilin operojnë grupet shqiptare ka bërë që të ketë më shumë raste të regjistruara për veprën penale "Grup i Strukturuar Kriminal" se sa për veprën penale "Organizata Kriminale". Në fakt, hetimet kanë

treguar se grupet shqiptare nuk përbëjnë një organizatë kriminale të mirëfilltë, e cila për të qenë e tillë duhet të ketë qëndrueshmëri në kohë, organizim vertikal, detyra të mirëpërcaktuara, financues të jashtëm, e karakterizuar nga kryerja e veprave penale

LAZARATI

Deri në vitin 2014, qendra kryesore të prodhimit të nënprodukteve të kanabisit ishin Lazarati në jug dhe Dukagjini në veri të vendit. Në mes të vitit 2014, dy operacione shumë të suksesshme policore janë kryer në këto dy zona dhe si pasojë u shkatërruan një numër shumë i madh i bimëve të kanabisit dhe një sasi e madhe e marijuanës.

jo gjithmonë të të njëjtit lloj. Ndërsa, në rastin e grupeve shqiptare që në të shumtën e rasteve janë proceduar për veprën "Grup i Strukturuar Kriminal", bëhet fjalë për një grup personash me lidhje familjare (shpeshherë edhe 4 persona, babai, nëna dhe fëmijët), të cilët bënda grupit nuk pranojnë të kenë një organizim vertikal, por secili kërkon të ketë një rol të rëndësishëm në grup që operojnë për një periudhë 2-3 mujore (zakonisht në periudhën e përshtatshme të kultivimit), pra jo shtrirje të gjerë në kohë dhe kryejnë vetëm një lloj vepre penale. Në vitin 2016, numri i procedimeve të regjistruara është

të rritur me 43%, krahasuar me vitin 2015. Për veprat penale të parashikuara nga neni 283 "Prodhimi dhe shitje e narkotikëve", neni 283/a "Trafikimi i narkotikëve" dhe neni 284 i Kodit Penal "Kultivimi i bimëve narkotikëve" janë regjistruar përkatësisht 39 %, 18,3 % dhe 48,7 % më shumë procedime, krahasuar me një vit më parë. Në dy vitet e fundit, dënimet e dhëna nga gjykata, në pjesën më të madhe të rasteve kanë rezultuar në mesataren e kufijve të masës së dënimit të parashikuar në ligj. Në arrijtjen e këtyre rezultateve gjatë dy viteve të fundit, institucioni që ka mbajtur dhe vazhdon të mbajë barrën kryesore në parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve ka qenë Policia e Shtetit (PSH). Pavarësisht se ky institucion zhvilloi veprimtari gjithëvjetore, ai i përqendron forcat dhe mjetet në periudhën qershor-shtator. Kjo periudhë përkon edhe me sezonin turistik për garantimin e rendit publik dhe të sigurisë në të gjitha plazhet dhe zonat turistike të vendit. Përveç kësaj, punonjësit e PSH-së angazhohen edhe në veprimtari të tjera për sigurinë publike si: aktivitete sportive, kulturore dhe politike (zgjedhjet) etj. Gjithashtu, gjatë këtyre dy viteve të fundit, kontribut në identifikimin e sipërfaqeve të kultivuara me bimë narkotike gjatë periudhës maj-shtator ka dhënë edhe Ministria e Mbrojtjes, ku helikopterët dhe mjetet e saj detyrë kanë monitoruar nga ajri dhe deti territorin dhe ujërat territoriale të vendit tonë. Janë realizuar mbi 441 orë fluturimi të helikopterëve ushtarakë, që përveç përmbushjes së misionit të tyre, kanë pasur si detyrë shtesë monitorimin e territorit dhe identifikimin e sipërfaqeve të mbjella me bimë narkotike në korridorët e fluturimit ajror. Janë kryer edhe rreth 91 orë lundrimi me mjetet e Forcave Detare në kuadër të zbatimit të ligjëshmërisë detare dhe nënter të përmbushjes së detyrës kundër trafikimit të lëndëve narkotike.

Shëndetësi

Në frenimin e përhapjes së psoriasis luajnë një rol të rëndësishëm edhe disa bimë mjekësore, të cilat janë jo vetëm një burim i pazëvendësueshëm i kripërave minerale, por edhe i vitaminave të ndryshme si vitamina A, B, C, D, E dhe acide triperpenoike, acidi salicilik, kafein, kripërat minerale të potasit të cilat rimiralizojnë sipërfaqen e dëmtuar të lëkurës. Pra, zvogëlojnë sëmundjen dhe rigjenerojnë lëkurën e dëmtuar.



Mjeku popullore: Ja faktorët kryesorë që ndikojnë në përhapjen e sëmundjes

Voltiza Duro

Psoriasis Vulgaris është një sëmundje kronike autoimmune e lëkurës, që shkaktohet në vende të ndryshme të trupit si gjunjët, bërrylat, krahet, veshët dhe në pjesët e poshtme. Në fillim kjo shfaqet si një pullë e kuqe në kafe dhe herë-herës mbulohet nga një cipë e hollë e bardhë. Psoriazma ndiqet nga një model, që në një pjesë të kohës krijon acarime, irritime të lëkurës, kurse në një pjesë tjetër, ajo bie në qetësi. Praktikisht, në stinën e vjeshtës dhe në dimër, kjo sëmundje qëndron e acaruar, ndërsa në verë e pranverë është më e qetë. Pra, psoriasis që ka lidhje me ndryshimin e shtypjes atmosferike dhe rritjen e lagështirës, për afrohet me shenjat e artritit reumatoid. Pra, edhe limiti i kësaj sëmundjeje përfundon në një artrit. Rreth 70% e njerëzve e zbulojnë këtë sëmundje nga mosha 20-30 vjeç dhe pastaj mësohen të bashkëtojnë me të derisa kjo sëmundje të përfundojë në një dhimbje kockash dhe kyçesh. Nëse njerëzit do të mundoheshin dhe të stresohen për shkaqet e sëmundjes dhe evolinim e mëtejshëm të saj, atëherë vetëm do të shtojnë sulmet që kjo sëmundje kryen mbi të sëmurin. Po kështu, kjo sëmundje nxitet edhe nga sëmundje infektive të ndryshme, acarim bajamesh, infeksion në rrugët urinare, plagosjet e lehta, prerjet e ndryshme, helmimet nga ushqimet, viruset apo bakteret (qofshin këto në sistemin urinar, respirator), djegia e tepërt nga dielli, teprira në konsumimin e alkoolit dhe duhanit. Po kështu, ndikim negativ në shfaqjen e psoriasis ka edhe përdorimi i steroideve, antiinflamatorëve të ndryshëm dhe be-tablokuesit. Psoriasis Vulgaris është një sëmundje shumë e rrallë tek ata njerëz që diëta është e pakët në yndyrna, në ato vende ku vitamina D është brenda normës në organizëm dhe tek ata që vitamina B kompleks, E dhe mineralet janë brenda normave. Ndërkohë të personat e prekur nga kjo sëmundje, një dietë ditore me rreth 50% fruta perime e zarzavate tre-

YLLI MERJA: Psoriasis, si ta frenoni me bimë medicinale

"Përdorni lëvoren e shelgut të bardhë e rrënjët e çikores"



Mjeku popullore
Ylli Merja

gon për një shkallë të ulët agresiviteti të psoriasis. Përdorimi i fibrave të shumta dhe i antioksidantëve bën që sistemi i qarkullimit të gjakut, duke përfshirë edhe kapilarët, të kenë elasticitetin e duhur, pra gjaku dhe oksigjeni të qarkullojnë lirshëm në të gjitha pjesët e trupit. Kështu, minimizohet sepërmi efekti agresiv i psoriasis mbi lëkurën. Nëse pacienti lan trupin me ujë të pastër deti disa herë në ditë dhe qëndron në diell nga ora 8.00-10.00 dhe nga 16.00-18.00 (orare ku rrezet UVB janë më pak shkatërruese për pjesën e sipërme të epidermës së lëkurës. Do të vëmë re se cipa e zbardhura dhe të plasur saritura të lëkurës do të pastrohen plotësisht dhe në minaturë do të ngelet vetëm një lëkurë e kuqe, e brishtë dhe e hollë. Nëse këtë veprim i sëmurit e përsërit disa ditë me radhë, zona e sëmurë fillon të rigjenerohet. Pra, uji i pastër

i detit, individit i siguron jo vetëm kripëra minerale, por edhe vitamina dhe antibiotikë që vetëm në këtë ujë gjenden. **TRAJTIMI ME BIMË MJEKËSORE**

Në frenimin e përhapjes së psoriasis luajnë një rol të rëndësishëm edhe disa bimë mjekësore, të cilat janë jo vetëm një burim i pazëvendësueshëm i kripërave minerale, por edhe i vitaminave të ndryshme si vitamina A, B, C, D, E dhe acide triperpenoike, acidi salicilik, kafein, kripërat minerale të potasit të cilat rimiralizojnë sipërfaqen e dëmtuar të lëkurës. Pra, zvogëlojnë sëmundjen dhe rigjenerojnë lëkurën e dëmtuar. Rrënja e çikores është një burim i pasur vitaminash dhe kripërash minerale, pasi përmban acide organike dhe inulinën (antibiotik që gjendet edhe tek hudhra). Edhe rrënja e çikores përmban kripëra të shumta minerale, që shërbojnë

lëkurën e dëmtuar e frenon përhapjen e psoriasis dhe zvogëlon maksimalisht efektet dëmtuese të psoriasisit mbi qelizat e rregullta të lëkurës që ndodhen në kufi me cipën e përhimtë të psoriasisit. Prania e vitaminës C, K, inulina kanë veti të rigjenerojnë lëkurën. Ndërkohë, lëvorja e shelgut të bardhë përdoret si një shpëlarës i lëkurës, pasi përmbajnë sasi të mjaftueshme të acidit salicilik. Gjithashtu, edhe lulja e kumakut është një bimë shumë efektive në kurimin e sëmundjes dhe në mbylljen e plagëve. Kështu, hidhni në një tenxhere 2 litra ujë dhe zieni në të për 2-3 minuta: 2-3 rrënjë çikoreje, 2-3

rrënjë radhiqesh, 1 dorë lëvore shelgu, 1 lugë gjelle dëllinjë të kuqe ose të zezë e në valën e fundit shtoni 1 lugë gjelle pelinë të ëmbël, 1 dorë kalendul dhe 1 lugë gjelle rigon. Hiqeni nga zjarri dhe lëreni të ftohet për rreth 15-20 minuta. Me këtë çaj mund të lani 2 herë në ditë vatrat me psoriasis dhe mund të pini 2 gota në ditë, po nga ky çaj. Efektet kurative të kësaj përgatitjeje duken brenda javës së parë. Është mirë që pasi të jetë tharë çaji, të vendosni kremi mbi plagët e psoriasis edhe kremin e përgatitur me esencat e ekstraktet e bimëve të sipërpërmendura të lidhura me dyllin e bletës.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje programesh Software për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 3.581.600 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutësi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshtkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje programesh Software për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 04 Korrik 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Administratori Elin Meka: Falënderime për grupin fitues dhe të pranishmit

Voltiza Duro

"Luarasi" zhvillon forumin e parë ekonomik për studentët

Dekani Spaho: Diskutim i hapur dhe pa paragjykime

Ditën e djeshme, në Kolegjin Universitar "Luarasi", u zhvillua për herë të parë Forumi Ekonomik Studentor me studentët e vitit të tretë të Fakultetit Ekonomik. Tema e diskutimit mbi të cilën u zhvillua debati ishte: "Taksimi - Një çështje për mirëqenien mbarëkombëtare", ku u fol mbi taksimin, një mjet që kontribuon në krijimin apo shkatërrimin e mirëqenies së një vendi. Pesë grupe të ndryshme studentësh me anë të prezantimeve të tyre shpalesh pikëpamjet e ekonomistëve ndërkombehtarë (dhe të tyre) mbi nivelet e ndryshme të taksimeve. U vlerësuan, gjithashtu, nga pikëpamja teorike modele të taksave të sheshta apo progresive, pikat e tyre të forta dhe ato që lënë për të dëshiruar. Në një prononcim për "Gazeta Shqiptare", dekani i Fakultetit të Ekonomisë në Kolegjin Universitar "Luarasi", Prof. as. Mateo Spaho tregon se gjatë debatit u bë dallimi i diferencave mes taksave dhe taksimeve si dhe u arsyetua situata lidhur me Shqipërinë. "Gjatë diskutimit në Forumin Ekonomik Studentor me studentët e vitit të tretë të Fakultetit Ekonomik në "Luarasi" u sqaruan në situata të ndry-



Forum Ekonomik Studentor me studentët e vitit të tretë të Fakultetit Ekonomik në Kolegjin Universitar "Luarasi"

shme të zhvillimit të vendeve nëse mund të ishte më i dobishëm një taksim i përqendruar mbi të ardhurat apo mbi pasuritë e paluajtshme. Duhet taksuar kapitali apo puna? U dalluan në diferencat midis taksave dhe

tatimeve si dhe u arsyetua nëse në rastin e Shqipërisë do të ishte më mirë një Taksim mbi Vlerën e Shtuar me një shkallë apo do të duhej një diferencim për ushqimet e shportës dhe produkteve të tjera", -u shpreh Spaho për


'GSH'. Ky i fundit më tej thekson se përtej përgjigjeve, ka qenë e rëndësishme vendosja e pyetjeve dhe diskutimi në vetvete i hapur dhe pa paragjykime apo ngjyrosje politike. I pranishëm në këtë aktivitet ish-

FITUESIT
"Fitues për këtë vit u shpall grupi me temë: 'Tatimi: Puna apo pasuria?', nga studentet Hasie Kotarja dhe Anxhela Rapo. Një falënderim shkon, gjithashtu, për të gjithë studentët pjesëmarrës në këtë forum dhe sukseset që gjithëve në provimet që nisnin së shpejti", -thotë Meka.

edhe administratori i Kolegjit Universitar "Luarasi" Prof. as. Elvin Meka, i cili së bashku me pedagogen Msc. Resina Pllaha, ishin pjesë e jurisë që përzgjedhën grupin fitues të debatit. "Fitues për këtë vit u

shpall grupi me temë: "Tatimi: Puna apo pasuria?", nga studentet Hasie Kotarja dhe Anxhela Rapo. Një falënderim shkon, gjithashtu, për të gjithë studentët pjesëmarrës në këtë forum, dhe sukseset që gjithëve në provimet që nisnin së shpejti", -thotë Meka. Në përfundim të aktivitetit, studenteve fituese iu dha një çmim simbolik nga ana e Kolegjit Universitar "Luarasi".

SYNIMI I AKTIVITETIT
Ky aktivitet ka pasur si synim të zhvillojë mendimin kritik dhe analitik të studentëve të Fakultetit Ekonomik në "Luarasi" dhe t'i përgatisë ata të jenë jo thjesht zbatues të politikave publike nëpër ministrinë e linjës dhe në administratën publike, por edhe të krijojnë pikëpamjet e tyre profesionale mbi nevojat që Shqipëria ka dhe mbi metodat e ndërhyrjes në rritjen apo uljen e niveleve tatimore në fushat e ndryshme të ekonomisë. Aktiviteti i organizuar në kuadrin e Forumit të studentëve të Ekonomisë do të jetë i përvitshëm dhe do të pasurohet në vijim edhe me pjesëmarrjen e autoriteteve dhe personaliteteve të rëndësishme në realitetin ekonomik të hapësirave shqiptare.



 REPUBLIKA E SHQIPËRISË

NJOFTIM PËR PJESËMARRJE NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE, PËR ANËTARËSIM NË KËSHILLIN TATIMOR

Në zbatim të kreu I, pika 2 të VKM nr.665, datë 4.8.2010 "Për përcaktimin e përbërjes dhe të mënyrës së funksionimit të këshillit tatimor, si dhe të kontributeve financiare të anëtarëve, që përfaqësojnë tatimpaguesit në këtë këshill", Ministria e Financave dhe Ekonomisë, fton përfaqësuesit e tatimpaguesve nga dhomave të tregtisë dhe industrisë, të shoqatave profesionale të ekspertëve kontabël, të shoqatave në fushën e ndërtimit/arkitekturës/inxhinjerisë që përfaqësojnë grupe të mëdha tatimpaguesish të marrin pjesë në procesin përzgjedhës për t'u anëtarësuar në Këshillin Tatimor.

Për përzgjedhjen e anëtarëve, përfaqësuesit e tatimpaguesve, në Këshillin Tatimor, ndiqen këto kritere:

- Përfaqësimi i tatimpaguesve, në Këshillin Tatimor, duhet të marrë në konsideratë kriterin e përfaqësimit gjeografik të tatimpaguesve, të kategorive të ndryshme të tatimpaguesve, si dhe të sektorëve të ekonomisë ku ata zhvillojnë veprimtarinë.
- Përfaqësuesit e tatimpaguesve, në Këshillin Tatimor, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - të kenë përvojë profesionale prej jo më pak se 3 (tre) vjet në çështje të administrimit të biznesit në Shqipëri;
 - të jenë anëtarë të një shoqate ose organizate të llojeve të përcaktuara në mënyrë sipër, dhe të autorizohen, me shkrim, nga titullari, për të përfaqësuar shoqatën ose organizatën;
 - të kenë përvojë të punës në grup dhe aftësi të mira komunikuese.

Dokumentacioni i nevojshëm për pjesëmarrje në procedurën përzgjedhëse dorëzohet brenda datës 28.06.2018, pranë protokollet të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në adresën: Blv "Dëshmorët e Kombit" nr.3, në një zarf të mbyllur me mbishkrimin "Për Sekretariatit Administrativ i Këshillit Tatimor".

- Formulari i aplikimit gjendet i publikuar në faqen zyrtare në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, www.financa.gov.al/al/newsroom/njoftime-dhe-aplikime
- Kopje e notizuar e aktit ligjor të regjistrimit të organizatës;
- Letër për emërimin zyrtar të përfaqësuesit të organizatës në Këshillin Tatimor, e nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i organizatës;
- Curriculum Vitae e personit që do të përfaqësojë organizatën tuaj në Këshillin Tatimor, ku të jetë identifikues qartë edhe përvoja profesionale në fushën e taksave (jo më pak se tre vjet).

Duke vlerësuar maksimalisht kontributin e përfaqësuesve të tatimpaguesve në përmirësimin e sistemit fiskal, inkurajojmë të gjitha organizatat që plotësojnë kriteret e mësipërme, të marrin pjesë në procedurën e përzgjedhjes për t'u anëtarësuar në Këshillin Tatimor.

Monitorim i rreptë në qendrat e vlerësimit

Matura Shtetërore, zbardhen datat për vlerësimin e tezave

Janë zbardhur datat e monitorimit dhe vlerësimit të tezave të provimeve të Maturës Shtetërore 2018-të. Këshilli i Ministrave ditën e djeshme ka miratuar udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë duke vendosur si afatet datat nga 10-30 qershor të këtij viti. "Periudha e monitorimit dhe grafiku i parqitjes së përfaqësuesve të grupit monitorues në QSHA është: a) Për lëndën "Gjuhë e huaj": 6-12 qershor 2018; b) Për lëndën "Gjuhë dhe Letërsi shqipe": 10-16 qershor 2018; c) Për lëndën "Matematikë": 15-21 qershor 2018; d) Për lëndët me zgjedhje: 22-30 qershor 2018", theksohet në Fletonen Zyrtare. Ndërkohë për drejtimin dhe mbarëvajtjen e procesit të vlerësimit, QSHA-ja të caktojë në çdo qendër dhe për secilin provim div specialiste, të cilët do të përzgjidhen dhe të trajnohen prej saj. Pas zhvillimit të çdo provimi, testet do të dërgohen nga shërbimi postar në masa sigurie në godinën e shkollës 9-vjeçare "Sabaudin Gabrani", Tiranë. QSHA-ja kryen inventarizimin dhe shpërndarjen e tyre në qendrat e vlerësimit. "Vlerësimi i testeve do të bëhet në qendrat e vlerësimit të mëposhtme: a) Në Tiranë, në godinën e shkollës "Sabaudin Gabrani", qendra nr. 1. b) Në Tiranë, në godinën e shkollës "Sabaudin Gabrani", qendra nr. 2. c) Në Elbasan, në godinën e shkollës "Vasil Kamami". d) Në Shkodër, në godinën e shkollës "Jordan Misja". e) Në Fier, në godinën e shkollës "Naim Frashëri". f) Në Korçë, në godinën e shkollës "Sevasti Qiriazhi", thuhet më tej në udhëzimin e MASR. Në këtë të fundit jepet urdhri që drejtoritë arsimore rajonale Tiranë, Elbasan, Shkodër, Fier dhe Korçë të marrin masa për lirimin

Faksimile e vendimit të qeverisë

UDHËZOJ:
KRKUI I PROVIMET E DËBTYRUARA DHE ME ZGJEDHJE TË MATURËS SHTETËRORE 2018

1. Për provimet e Maturës Shtetërore ndëgjendur dhe përcaktuara në udhëzimin nr. 672, datë 29.12.2017, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, "Përcaktimin e regjistrimit për zhvillimin e Maturës Shtetërore 2018 në Republikën e Shqipërisë".

2. Përcaktimin e kapacitetit potencial të sekretit (KOEPS) për Maturën Shtetërore 2018 si jenë:
a) 29 maj-4 qershor 2018;
b) 4 qershor-8 qershor 2018;
c) 8 qershor-13 qershor 2018;
d) 13 qershor-20 qershor 2018.

3. Të drejtin e përzgjedhjes së mësuesish të testit përfundimtar për çdo lëndë e lëndë përzgjedhëse e testit përfundimtar (PTF) të ngarkuar me udhëzimin të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe specialistëve pedagojikë i përcaktuar në udhëzimin e drejtorit të QSHA-së. Përzgjedhja bëhet me procesverbal.

4. Faqja e punësimit të QSHA-së, të

e) Në Fier, në godinën e shkollës "Naim Frashëri".
f) Në Korçë, në godinën e shkollës "Sevasti Qiriazhi".

8. Drejtoritë arsimore rajonale Tiranë, Elbasan, Shkodër, Fier dhe Korçë të marrin masa për lirimin e mjediseve për vlerësimin e testeve në godinat e sipërpërmendura, të cilat do të ruhen me shërbim 24-orësh nga Policia e Shtetit, gjatë periudhës 06-28 qershor 2018.

9. Transporti i testeve nga Tiranë për në secilin nga qendrat e vlerësimit Elbasan, Shkodër, Fier, Korçë dhe anasjelltas, të bëhet me autotunet e DAR-së përkatëse dhe nga grupet monitoruese, të përcaktuara në pikën 14 të kësaj udhëzimesi, nën masat të nevojshme.

KRKUI II
MONITORIMI I PROCESIT TË PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE 2018

10. DAR/ZA-të të marrin të gjitha masat për krijimin e infrastrukturës së nevojshme për funksionimin e aparatave të bilbilimit/shërbimit të nevojshëm 24-orësh nga Policia e Shtetit, gjatë periudhës 06-28 qershor 2018.

e mjediseve për vlerësimin e testeve në godinat e sipërpërmendura, të cilat do të ruhen me shërbim 24-orësh nga Policia e Shtetit, gjatë periudhës 06-28 qershor 2018. v.u.d.

Mbledhja e Këshillit Bashkiak, cilat janë vendimet që priten të miratohen sot

Voltiza Duro

Paraditen e sotme do të mbahet mbledhja e radhës së Këshillit Bashkiak të Tiranës, ku priten miratimi i projektvendimit për trajtimin me bonus strehimi për 217 familje në nevojë, që nuk përballojnë dot qiranë e tregut. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot emrat e 217 aplikantëve, ku 105 prej tyre kanë dorëzuar dokumentacion të rregullt dhe kështu mund të njihen edhe me masën e përfitimit. "Për të zgjidhur problemet e strehimit në qytetin e Tiranës, Bashkia e Tiranës me qëllim ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave është duke ndërmarrë projekte të rëndësishme, që do të krijojnë zgjidhje përfundimtare për strehimin nëpërmjet ndërtimeve të banesave sociale me qira", - theksohet në relacion. Në kuadër të këtij projekti, Bashkia e Tiranës po vijon me zbatimin e ofritit të bonusit të strehimit, që përcakton një shumë të ardhurash mujore, që i takojnë një familjeje si ndihmë nga shteti, për të mbuluar pjesërisht pagesën e

Lista e plotë me 217 familjet që do të trajtohen me bonus strehimi

Emrat e qytetarëve në nevojë, që përfitojnë nga projektvendimi

qirave të tregut të lirë. Bonusi i strehimit jepet nga njësitë e qeverisjes vendore, me miratim të këshillave të tyre. Ndërkohë, Drejtorja e Strehimit Social parashtron se do të punojë aktualisht me vendimin nr. 15, me qëllim zgjidhjen emergjente për kategoritë sociale që kanë aplikuar për bonus strehimi. "Nisur nga fakti se numri i kërkesave të familjeve në nevojë për trajtim me strehim për subvencionimin e qirasë së banesës është shumë i lartë dhe në rritje, dhe nga ana tjetër ende nuk kemi zyrtarisht të dhëna mbi vlerën e çmimit të qirave minimale në treg,

kërkojmë vlerësimin për miratim të listës emërore të familjeve për trajtim me bonus strehimi. Në kuadër të trajtimit me bonus strehimi, pranë Drejtorisë së Strehimit Social kanë dorëzuar dokumentacionin për të përfituar nga kjo alternativë gjithsej janë 217 aplikantë/familje, ku ndër to rezultuan 105 aplikantë/ familje me dokumentacion të rregullt dhe 112 aplikantë/ familje me dokumentacion jo të rregullt", - thuhet në projektvendim. Ditën e sotme priten të miratohet edhe vendimi për dhënien e ndihmës financiare për 30 familje të prekura nga dëmet natyrore.

FAMILJE TE CILAT KANE PARAQITUR DOKUMENTACIONIN E KERKUAR PERFITOJNE SHUMEN SI ME POSHTE VII ON:

Emër	Mbiemër	Masa që përfiton	Miratuar me VKB
1. Shpetim	Daci	11 790 lekë	
2. Marieta	Rustemi	6 960 lekë	
3. Ylli	Ymeri	11 417 lekë	
4. Andrea	Dimushi	6 960 lekë	
5. Agim	Lamçe	9 097 lekë	
6. Sadete	Demiri	6 960 lekë	
7. Bashkim	Ymeri	887 lekë	
8. Besa	Dusha	11 790 lekë	VKB 89, datë 29.12.2016
9. Dhimitër	Dhimitri	10 385 lekë	
10. Shemzi	Lami	6 960 lekë	
11. Yllka	Baçova	13 830 lekë	VKB 89, datë 29.12.2016
12. Vjollca	Pasho	6 960 lekë	VKB 65, datë 07.10.2016
13. Sanije	Mane	11 790 lekë	
14. Hazis	Bitri	6 960 lekë	
15. Arentina	Metushllari	9 746 lekë	
16. Arzije	Nezha	11 216 lekë	VKB 65, datë 07.10.2016
17. Besim	Shehu	8 000 lekë	VKB 27, datë 23.05.2016
18. Lindita	Bardhi	6 960 lekë	VKB 39, datë 05.04.2017
19. Marte	Deda	11 790 lekë	
20. Agron	Arap	11 790 lekë	VKB 39, datë 05.04.2017
21. Shqiponja	Marku	11 790 lekë	VKB 39, datë 05.04.2017
22. Fatime	Çela	6 960 lekë	
23. Kasem	Tahiri	6 960 lekë	
24. Irma	Tema	16 870 lekë	VKB 89, datë 29.12.2016
25. Fatbardha	Lahi	11 790 lekë	VKB 89, datë 29.12.2016
26. Sulejman	Kurishi	6 960 lekë	
27. Fatmir	Serjani	11 790 lekë	
28. Arben	Guga	6 960 lekë	VKB 39, datë 05.04.2017
29. Demir	Mejdani	10 983 lekë	VKB 65, datë 07.10.2016
30. Ivzi	Ismaili	2 924 lekë	VKB 43, datë 06.07.2016
31. Gato	Kukeli	6 960 lekë	VKB 43, datë 06.07.2016
32. Fatmire	Hoxha	6 960 lekë	
33. Xhilda	Rapo	16 870 lekë	VKB39, datë 05.04.2017
34. Esmeralda	Xhaka	6 960 lekë	
35. Ajshe	Kortoçi	6 520 lekë	
36. Kujtim	Farasholli	5 544 lekë	VKB 37, datë 23.05.2016
37. Rajmonda	Rexhepaj	16 870 lekë	VKB 39, datë 05.04.2017
38. Alidije	Bregu	8 453 lekë	
39. Ervar	Krasniqi	6 960 lekë	
40. Bukurije	Feçi	11 790 lekë	VKB 43, datë 06.07.2016
41. Luljeta	Hamzaj	6 960 lekë	
42. Elton	Ismaili	6 960 lekë	
43. Merita	Bozo	6 960 lekë	
44. Lefterie	Ibrahim	1 355 lekë	
45. Dallandyshe	Kasaj	11 109 lekë	VKB 39, datë 05.04.2017
46. Manushaqe	Baçaj	6 960 lekë	VKB 89, datë 29.12.2016
47. Natasha	Bajramaj	6 960 Leke	VKB 65, datë 07.10.2016
48. Valentina	Qyra	9 399 lekë	
49. Mariela	Sula	6 960 lekë	VKB 39, datë 05.04.2018
50. Klarita	Mollaj	6 960 lekë	
51. Qendrim	Shehu	6 960 lekë	
52. Shpresa	Berisha	11 790 lekë	
53. Shqiponja	Kadisi	11 790 lekë	VKB 89, datë 29.12.2016
54. Asllan	Budlla	5 798 lekë	VKB 52, datë 06.06.2017
55. Ylli	Shyrba	6 960 lekë	
56. Dallandyshe	Hasa	11 109 lekë	VKB 39, datë 05.04.2017

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME BONUS STREHIMI

1. Erjona Gishti	70. Margalina Mullisi	145. Marleta Rustem
2. Selim Sefa	71. Destudana Alija	146. Ylli Ymeri
3. Kujtim Ymeri	72. Meleqe Sula	147. Andrea Dimushi
4. Ruke Dooçaj	73. Edlira Sallaj	148. Agim Lamçe
5. Klodjana Sinani	74. Aleksandra Meta	149. Sadete Demiri
6. Zhaneta Kruja	75. Rozina Kertuka	150. Bashkim Ymeri
7. Vladimir Dumi	76. Vjollca Lula	151. Besa Dusha
8. Majlinda Ndoj	77. Lindita Arixhju	152. Dhimitër Dhimitri
9. Selim Kaca	78. Hathe Lamçe	153. Shemzi Lami
10. Kujtim Nurka	79. Flavia Naska	154. Yllka Baçova
11. Bujar Mustafaj	80. Vjollca Lula	155. Vjollca Pasho
12. Kadri Birja	81. Lindita Arixhju	156. Sanije Mane
13. Brisida Shkrepi	82. Hathe Lamçe	157. Azis Bitri
14. Gentian Diko	83. Flavia Naska	158. Arentina Metushllari
15. Rozeta Bacova	84. Dallandyshe Kocoku	159. Arzije Nezha
16. Albert Brari 17. Lumturije Cila	85. Besnik Zeneli	160. Xhilda Rapo
17. Lumturije Cila	86. Shkendije Nuri	161. Besim Shehu
18. Qazim Bruka	87. Debora Bacelli	162. Lindita Bardhi
19. Leonard Koci	88. Valbona Musaj	163. Made Deda
20. Hysni Zerehallari	89. Ndrilcim Plloci	164. Agron Arapi
21. Eresjda Mama	90. Bora Gurina	165. Lefterie Ibrahim
22. Anamaria Licaj	91. Kostandin Murizi	166. Merita Bozo
23. Femi Mersini	92. Sefedin Goza	167. Elton Ismaili
24. Krenar Jaho	93. Gezim Jashari	168. Luljeta Hamzaj
25. Imer Xhauri	94. Bujar Muharemi	169. Bukurije Feçi
26. Mihat Kukli	95. Astrit Demiri	170. Ervar Krasniqi
27. Asllan ciba	96. Kujtim Orgji	171. Alidije Bregu
28. Dritan Mucanji	97. Kujtim Maliqi	172. Rajmonda Rexhepaj
29. Liljana Mecaj	98. Anife Muharemi	173. Kujtim Farasholli
30. Festime (et	99. Ardian Serjani	174. Ajshe Kortoci
31. Adeline Onuzi	100. Altin Istin	175. Esmeralda Xhaka
32. Natasha Tahiri	101. Perparim Gatali	176. Sherif Imeraj
33. Valentina Ballanca	102. Hidajet Qerimi	177. Fatmire Hoxha 180. Gato Kukeli
34. Lindita Male	103. Zamir Demiri	181. Ivzi Ismaili
35. Megi Fishta	104. Mihal Mehmeti	182. Demir Mejdani
36. Selim Mujaj	105. Drita Hasan	183. Arben Guga
37. Alma Sogani	106. Fuad Shaku	184. Fatmire Serjani
38. Gentian Lamçe	107. Inedit Berisha	185. Sulejman Kurushi
39. Mirela Xhelili	108. Qamile Nuredini	186. Fatbardha Lahi
40. Bruno Mamali	109. Zamira Muharemi	187. Irma Tema
41. Lushe Muslia	110. Fatjon Shaba	188. Kasem Tahiri
42. Agim Basha	111. Romeo Sulejmani	189. Fatime Cela
43. Kasije Basha	112. Bilbil Shupli	190. Shqiponja Marku
44. Kastriot Hutli	113. Panajot Serjani	191. Ylli Shyrba
45. Gezim Dibra	114. Sokrat Kovaci	192. Asllan Budlla
46. Selim Mujaj	115. Landi Serjani	193. Shqiponja Kadu
47. Anila Kurtaj	116. Zejine Kaloshi	194. Shpresa Berisha
48. Hmi Barci	117. Fahrije Ruja	195. Meliha Lala
49. Beq Bucaj	118. Erzen Kallo	196. Qendrim Shehu
50. Nelson Vilacaj	119. Gjyste Madani	197. Klarita Mollaj
51. Perparim Gatali	120. Safije Haka	198. Mariela Sula
52. Hidajet Qerimi	121. Altin Hyseni	199. Valentina Qyra
53. Zamir Demiri	122. Fidarje Arixhju	200. Natasha Bajramaj
54. Leonora Haxhju	123. Drita Mustafaj	201. Manushaqe Thaci
55. Perit Pema	124. I suf Kurtaj	202. Dallandyshe Kasaj
56. Aferdita Toca	125. Emiljano Kurtaj	203. Dallandyshe Hasa
57. Klodiana	126. Ana Berziu	204. Gezim Jashari
58. Dyrnishi	127. Elsad Duko	205. Ledjon Muharemi
59. Mehdi Haskasa	128. Mark Bjesku	206. Abaz Sherif
60. Vjollca Pellumbi	129. Gashe Hidersha	207. Ramazan Sherif
61. Agim Basha	130. Arvin Metellari	208. Arben Mejdani
62. Xhira Gjoshi	131. Donjeta Xhakollari	209. Klodjan Shaba
63. Serme Murga	132. Arben Canushi	210. Shpetim Berisha
64. Shkelqim Lenja	133. Anila Xhabaffi	211. Dritan Berisha
65. Agim Zeneli	134. Ylli Collaku	212. Natasha Sherifi
66. Pellumb Kaso	135. Aishe Kanina.	213. Mimoza Sherifi
67. Fitim Fasho	136. Asja Kruja	214. Erace Sherifi
68. Kujtim Hysmeta	137. Marte Kovaci	215. Zamira Karimani
69. Gentjan Demiri	138. Mirela Xhelili	216. Anila Dako
70. Ediana Haziri	139. Durim Ferhat	217. Zamir Mejdani
71. Sadete Gerani	140. Arben Gozha	
72. Zenepe Sinani	141. Shpetim Cibaku	
	142. Oliver Cibaku	
	143. Erbin Cibaku	
	144. Shpetim Daci	

Kol Nikollaj: Ne jemi të bashkuar, qeveria po nxit debat që të shtyjë miratimin e statusit

Minatorët: Të martën, grevë pa afat para Kryeministritë

Krerët e sindikatave: Do djegim ISSH-në, është e korrumpuar

Voltiza Duro

Minatorët i kanë dhënë një javë afat qeverisë për të miratuar statusin e punonjësve të nëntokës, në të kundërt do të protestojnë pa lëvizur nga dera e Kryeministritë e madje do të fillojnë edhe grevën pa afat. Këto deklarata janë bërë ditën e djeshme gjatë protestës ku morën pjesë minatorët në pension si dhe përfaqësues nga sindikata të ndryshme që mbrojnë interesat e kësaj kategorie. Në një prononcim për "Gazeta Shqiptare", kreu i Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë, Kol Nikollaj tregon se tashmë të gjitha sindikatat janë të bashkuara e nuk do të ndalen deri në miratimin e statusit. "Pasi u miratuan të gjitha procedurat për miratimin e statusit të minatorit, ende nuk ka asnjë përgjigje konkrete, pra mesa duket duan ta shtyjë. Por ne kërkojmë miratimin para se ligjvënësit të marrin pushimet e verës. Gjatë protestës pati edhe të shoqëruar në komisarjat, ku i mbajtën pak kohë, i morën në pyetje dhe i liruan sërish. Ne kemi organizuar një grup negociator nga 3 sindikata dhe të martën do të protestojmë sërish", thekson Nikollaj për "GSH".



AKSIONI
Edhe pse policia e Tiranës iu ka refuzuar kërkesën për tubim para Kryeministritë, minatorët kanë vijuar aksionin e tyre ku kërkuan njëzëri të drejtën për statusin e minatorit. "Jemi brenda rregullave, është protestë paqësore, jo për të shkatërruar e djegur. Kërkojmë të drejtat tona. Minatorët kërkojnë statusin e tyre."

KOL NIKOLLAJ: TË MARTËN PROTESTË
"Pasi u miratuan të gjitha procedurat për miratimin e statusit të minatorit, ende nuk ka asnjë përgjigje konkrete. Por ne kërkojmë miratimin para se ligjvënësit të marrin pushimet e verës. Ne kemi organizuar një grup negociator nga 3 sindikata dhe të martën do të protestojmë sërish", - thekson Nikollaj për "GSH".



MARK GJERGJI: DO LUFTOJMË DERI NË FUND
"Të martën do të jemi te Kryeministria dhe do të rrimë aty, derisa të bëjnë miratimin e statusit. Jemi këtu për të paralajmëruar qeverinë se pavarësisht të drejtave të shkelura, ne nuk do të dorëzohemi por do të luftojmë deri sa të jemi gjallë. Na premtuan që do miratohet, e tani na e shtynë sërish", - shprehet minatori në pension, Mark Gjergji për "GSH".



FIQIRI XIBRI: DO DJEGIM ISSH-NË
"ISSH është kthyer në bandë korrupsion dhe akoma nuk ka filluar puna për të pastruar skemën nga hajdutët. Nuk ka rëndësi se kush e organizon, të jemi të gjithë bashkë, të luftojmë të gjithë bashkë dhe radhën tjetër nuk largohemi më pa e realizuar statusin. Do i vëmë flakën Institutit të Sigurimeve Shoqërore", - deklaroi Xibri.



kemi bërë bisedime me ministrin përkatës, ka qenë zv.ministri në tavolinë dhe kemi rënë dakord për pikat e statusit. Si status ka përfunduar, ka kaluar të gjithë institucionet por nuk e kuptojmë pse vjen ky ngërç. Ndaj ne do dalim në

- KËRKESAT E MINATORËVE**
1. Pagat minimale, jo më pak se 200 përqind e pagës minimale zyrtare, ose 44 mijë lekë
 2. Kërkojnë që pensioni minimal të jetë 131 përqind i pagës minimale, ose rreth 29 mijë lekë
 3. Përkallëzim i moshës së pensionit
 4. Reduktim i viteve të punës
 5. Përqindje përfitimi financiar mbi bazën e vjetër sisë në punë
 6. Mbrojtje të familjeve të minatorëve të aksidentuar me vdekje në minierë.
 7. Shpenzimet për mjekimi të mbuloohen shtetit dhe punëdhënësi
 8. Shteti të sigurojë arsimin dhe edukimin për minatorët që kanë humbur jetën

protestë para kryeministritë që ky status të jepet në kohën sa më të shkurtër. Ne jemi të organizuar në mënyrën më të mirë të mundshme", deklaroi Taf Koleci, sekretar i përgjithshëm i Federatës së Sindikatave të Punonjësve të Industrisë të Shqipërisë. Ndërkohë edhe kreu i sindikatës së minatorëve, Fiqiri Xibri ka bërë thirrje që të gjitha sindikatat dhe të gjithë minatorët të bashkohen e madje ka paralajmëruar se do i vënë flakën ISSH-së. "Rëndësi ka që minatorët të jenë të gatshëm për të luftuar për të drejtat e veta. Nuk ka rëndësi se kush është në qeveri PS apo PD, nuk ka rëndësi se cila është sindikata që përfaqëson sot ose nesër, ose dje, rëndësi ka që ne të jemi të gatshëm për të mbrojtur veten tonë, dinjitetin tonë, gjakun tonë që e kemi lënë nëpër miniera dhe qeveritë nuk e njohin. ISSH është kthyer në bandë korrupsion dhe akoma nuk ka filluar puna për të pastruar skemën nga hajdutët. Nuk ka rëndësi se kush e organizon, të jemi të gjithë bashkë, të luftojmë të gjithë bashkë dhe radhën tjetër nuk largohemi më pa e realizuar statusin. Do i vëmë flakën Institutit të Sigurimeve Shoqërore", - deklaroi Xibri.

Ministritë, akuza sindikatave: Konfliktet tuaja kanë shtyrë statusin

Pas protestës së zhvilluar ditën e djeshme nga përfaqësues të sindikatave për "Statusin e minatorit", Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë bashkë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë kanë akuzuar sindikatat për shtyrjen e këtij procesi. "Fatkeqësisht, deri tani, ka dhe një pjesë përfaqësuesish sindikalë, të cilët nuk kanë rënë dakord me draftin e propozuar nga pjesa kryesore e sindikalistëve. Gjurmë rastin që t'u bëjmë



thirrje të gjithë përfaqësuesve sindikalë që të bëhen pjesë e diskutimeve në tryezën e grupit të punës, të bashkohen në qëndrime mbi një draft të vetëm, i cili më pas t'i nënshtrohet procedurave të përcaktuara në ligj", thuhet në deklaratën e përbashkët të ministrive. Në këtë të fundit theksohet se prej disa kohësh është funksional një grup ndër-institucional pune i përbashkët që kryesohet nga zv.ministrat përkatës Enis Aliko dhe Dajna Sorensen.

Ky grup pune ka zhvilluar diskutime intensive me përfaqësuesit e sindikatave, pjesa më e madhe e të cilëve janë dakordësuar me tyre për një draft të cilin ja kanë paraqitur grupit të punës.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, kreu i KSSH-së tregon se e gjithë kjo po bëhet nga ana e qeverisë për të nxitur debata e për të shtyrë miratimin e statusit.

PROTESTA
Edhe pse policia e Tiranës iu ka refuzuar kërkesën për tubim para Kryeministritë, minatorët kanë vijuar aksionin e tyre ku kërkuan njëzëri të drejtën për statusin e minatorit. "Jemi brenda rregullave, është protestë paqësore, jo për të shkatërruar e djegur. Kërkojmë të drejtat tona. Minatorët kërkojnë statusin e tyre. Ne do ta vazhdojmë protestën. Kërkojmë një të drejtë që duhet të ishte dhënë që në fillim të demokracisë. Ne

Dosjet e viteve 1993-2008, formulari-tip për informim në lidhje me ecurinë vendimeve

Ornela Manjani

Pronarët në Korçë, ATP merr në shqyrtim 10 mijë dosje

Problematikat, procedurat për t'u njohur me ecurinë e shqyrtimit

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 10 mijë dosje ish-pronarësh, që janë në proces shqyrtimi nga kjo agjenci. Kërkesit janë në garkun e Korçës. Në listën e përditësuar jepet numri i dosjes dhe data e aplikimit, gjeneralitetet e kërkesit, sipërfaqet e njohura për kompensim, dosjet për pronarët që kanë marrë vendim negativ dhe dosjet që duhet të plotësohen. Dosjet janë të viteve 1993 deri në vitin 2008. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vënë në dispozicionin të pronarëve formularin tip, "Informacion në lidhje me ecurinë e dosjes", i cili duhet të plotësohet dhe të dorëzohet në Agjencinë për t'u njohur me fazën në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj. Agjencia Trajtimit të Pronave është e detyruar që brenda 15 ditëve nga momenti i dorëzimit të kërkesës t'i kthejë përgjigje pronarit në lidhje me ecurinë e dosjes.

FORMULARI

Formulari i aplikimit për informacion në lidhje me ecurinë e dosjes është i ndarë në tri seksione. Aplikanti duhet të plotësojë gjen-

eralitet, adresën dhe të jetë i pajisur me mjet identifikimi në momentin e aplikimit. Në seksionin e dytë duhet të jetë përshkruar në mënyrë të saktë se në lidhje me çfarë kërkon informacion pala e interesuar, në këtë rast pronarët që ka aplikuar për kthim e kompensim prone. Dhe në seksionin e fundit janë të specifikuar pesë dokumentet që duhet të disponojë pronari në momentin e aplikimit.

APLIKIMI

Për t'u njohur me ecurinë e dosjes, subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë dorazi ose me postë pranë ATP-së kërkesën përkatëse me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes, fotokopje të kartës së identitetit, dëshmi trashëgimie

DOKUMENTACIONI QË DUHET TË PARAQISNI

- Formulari-tip
- Fotokopje e kartës së identitetit
- Kopje vendimi nga ish-KKP/AKKP (nëse ka)
- Dokumente të tjera

dhe prokurë të posaçme. Në faqen zyrtare të ATP-së mësohet se subjekti plotëson kërkesën me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, në 'Agjencinë'. Më pas, kërkesa i kalon zyrës së protokollit, e cila pasi e protokollon, ia dërgon të gjitha kërkesat e ardhura drejtorit të përgjithshëm. Kreu i AKKP-ës ia delegon kërkesat sek-

torit përkatës për ndjekje dhe zbatim. Më pas, sektori përkatës përgatit informacionin e kërkuar dhe njofton subjektin. Në përfundim të shqyrtimit, subjekti paraqitet pranë zyrave të ATP-së për të tërhequr shkresën e kthimit të përgjigjes në lidhje me ecurinë e dosjes ose i dërgohet me postë, sipas kërkesës. Aplikimi për kërkesën për informim mbi dosjen nuk ka kosto.

KORÇË

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kërkesues)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkesues)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
337	Korçë	Ndreko	Kosta	Drako	1 800	Titull ekzekutiv dt. 07.04.2008.
		Ndreko	Kosta	Drako	1 800	Titull ekzekutiv dt. 25.09.2008
		Ndreko	Kosta	Drako	1 800 me te drejten e parablejtes	
144	Korçë	Çlirim	Izet	Begolli	10 500	Titull ekzekutiv dt. 30.11.2007
145	Korçë	Osman	Hoxha	Hoxha	160 000	Titull ekzekutiv dt. 15.11.2007
147	Korçë	Flora	Apostol	Bica	12 000	Titull ekzekutiv dt. 10.08.2007
101	Korçë	Sejat	Berberi	Berberi	2 000	Titull ekzekutiv dt. 03.06.2007
102	Korçë	Nezhdet	Shemshedin	Sherif	24 148	Titull ekzekutiv dt. 30.11.2007
334	Korçë	Pavilo	Vasillaq	Nase	39480	Titull ekzekutiv dt. 29.04.2008
15	Korçë	Leonora	Vasili	Grashani	27 600	Titull ekzekutiv dt. 12.10.2009
10	Korçë	Zhujeta	Zare	Begvarfaj	34250	Titull ekzekutiv
338	Korçë	Eqerem	Bezati	Bezati	3000	Titull ekzekutiv
		Eqerem	Bezati	Bezati	Korrigjim i gabimeve materiale te 355	
319	Devoll	Ilo	Pandi	Deli	160	Titull ekzekutiv
326	Pogradec	Safet	Izet	Berberi	11619	Titull ekzekutiv
331	Devoll	Maksim	Trojani	Trojani	10 000	Titull ekzekutiv
332	Devoll	Nefaret	Ulomi	Ulomi	19 000	Titull ekzekutiv
312	Korçë	Arben	Shushi	Shushi	200	Titull ekzekutiv
309	Korçë	Ylika	Qazim	Xhumari	445	Titull ekzekutiv
308	Pogradec	Ali	Qazim	Dule	21 500	Titull ekzekutiv
67	Korçë	Ervehë	Bendo	Bendo	22 000	Titull ekzekutiv
		Ervehë	Bendo	Bendo	17 000	Titull ekzekutiv
63	Korçë	Erver	Riza	Xhakolli	1 350	Titull ekzekutiv
78	Korçë	Robert	Papi	Papi	7 000	Titull ekzekutiv
76	Pogradec	Robert	Papi	Papi	44 000	Titull ekzekutiv
		Robert	Papi	Papi	44100	Titull ekzekutiv
		Robert	Papi	Papi	Mosnjohje e sip. 44100m ²	
		Robert	Papi	Papi	Lenie ne fuqi e 726.21.10.2008	Titull ekzekutiv
132	Korçë	Vasil	Lisimak	Kondi	Mosmiratim Kerkese	
		Vasil	Lisimak	Kondi	Lenie nefuqi e 178.04.09.2007	Titull ekzekutiv
183	Korçë	Ali	Hasan	Zhabollari	157500	Titull ekzekutiv Sip. prej 2250 m ² eshte trajtuar me mosnjohje
182	Korçë	Ridvan	Male	Male	10000	Titull ekzekutiv
181	Korçë	Ilia	Koco	Thaka	3211	Titull Ekzekutiv
		Ilia	Koco	Thaka	37 000	Titull Ekzekutiv
224	Korçë	Klara	Aleko	Bibolli	1 500	Titull Ekzekutiv
180	Korçë	Feritlet	Mysert	Piaku	1 500	Titull Ekzekutiv
177	Korçë	Vasi (Nli), Petref	Sulejman	Ylli	177 908	Titull Ekzekutiv
391	Korçë	Ilia	Bode	Bode	4000	Titull Ekzekutiv
399	Korçë	Petra	Giorgji	Mato	4750	Titull Ekzekutiv
413	Korçë	Ibrahim	Islam	Shehu	1 300	Urdrher Nr. 772/3.06.01.2010) Dr.Pergj. Moushtrim inikriative per 927
436	Korçë	Izmini	Mitrush	Caka	1669 me te drejten e parablejtes	Titull Ekzekutiv
470	Korçë	Adelina	Vasili	Qako	18 000	Titull Ekzekutiv
498	Korçë	Jovan	Gaqo	Marko	2250	Titull Ekzekutiv
25	Korçë	Spanja	Dhori	Pipa	34 480	Titull Ekzekutiv
		Spanja	Dhori	Pipa	34480	Titull Ekzekutiv
26	Korçë	Agim	Hamit	Dangelli	5 000	Titull Ekzekutiv
27	Pogradec	Silvana	Niko	Bozdo	1128	Titull Ekzekutiv
28	Pogradec	Bafjar	Elmasllari	Elmasllari	1124	Titull Ekzekutiv
29	Kolonje	Fatmir	Bregu	Bregu	550 000	Titull Ekzekutiv
24	Korçë	Ylli	Karaku	Karaku	7 000	Titull Ekzekutiv

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kërkesues)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkesues)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
32	Korçë	Theodorhaga	Vasil	Bardhlyi	Mosnjohje prone	
16	Korçë	Romeo	Sancolli	Sancolli	Mosnjohje prone	
398	Pogradec	Kaçka	Sandri	Kacka	Rrezim Kerkese	sipas njfotim nr. 998/a dt. 01.04.2013 te AKKP-se 388 perben titull ekzekutiv
						sipas njfotim te AKP-se nr. 290/16 dt. 21.03.2013 vendimi 373 perben titull ekzekutiv
290	Korçë	Bazelli	Hysi	Hysi	Rrezim Kerkese	sipas njfotim te AKP-se nr. 1006/4 dt. 20.09.2013 ky vendim perben titull ekzekutiv
1006	Kolonje	Priti	Priti	Priti	Rrezim Kerkese dhe mosnjohje	e paplotesuar rubrika e titullit ekzekutiv
65	Korçë	Florian	Vila	Vila	Mosnjohje prone	e paplotesuar rubrika e titullit ekzekutiv
376	Devoll	Devoll	Ocka	Ocka	15 600	e paplotesuar rubrika e titullit ekzekutiv
788	Korçë	Osmani	Kadiu	Kadiu	Mosnjohje prone	e paplotesuar rubrika e titullit ekzekutiv
646	Korçë	Yllson	Petriti	Petriti	Mosnjohje prone	e paplotesuar rubrika e titullit ekzekutiv
632	Korçë	Qyteza	Qyteza	Qyteza	Mosnjohje prone	e paplotesuar rubrika e titullit ekzekutiv
540	Korçë	Pandeli	Teneqexhi	Teneqexhi	Mosnjohje prone	e paplotesuar rubrika e titullit ekzekutiv
695	Korçë	Gaqo	Collaku	Collaku	Mosnjohje prone	e paplotesuar rubrika e titullit ekzekutiv
1174	Devoll	Liza	Muha	Muha	Mosnjohje prone	e paplotesuar rubrika e titullit ekzekutiv
773	Korçë	Ilo	Panariti	Panariti	Mosnjohje prone	e paplotesuar rubrika e titullit ekzekutiv
647	Korçë	Dashamir	Kodra	Kodra	Mosnjohje prone	e paplotesuar rubrika e titullit ekzekutiv
792	Korçë	Liri	Nikolla	Nikolla	Mosnjohje prone	e paplotesuar rubrika e titullit ekzekutiv
782	Korçë	Spiro	Cule	Cule	Mosnjohje prone	e paplotesuar rubrika e titullit ekzekutiv
188	Korçë	Vasfi	Goroveci	Goroveci	Mosnjohje prone	e paplotesuar rubrika e titullit ekzekutiv
539	Pogradec	Flamur	Çerra	Çerra	258	Titull Ekzekutiv (per sip. 196 m ² eshte shprehur me mosnjohje)
99	Pogradec	Servet	Musollari	Musollari	2626 m ²	Titull Ekzekutiv
578	Pogradec	Çlirime	Mulla	Mulla	31880	Titull Ekzekutiv
160	Pogradec	Çlirime	Mulla	Mulla	35 m ² - njohje (mosnjohje) per sip. 1250 dhe sip. 1 200)	Ne kushtet e n. 22 tithimi i sip. Se 09/ur me 15 dt. 03.09.2001
37	Pogradec	Skender	Musollari	Musollari	118 m ² - njohje 257 - mosnjohje	
128	Pogradec	Bujar	Xhenollari	Xhenollari		
270	Pogradec	ZVASH KORÇE				
83	Korçë	Luiza	Çekani	Çekani	72236 dhe 20 708	336
71	Korçë	Fatmira	Bllaca	Bllaca	7254	Per sip. 6750 m ² 50 eshte shprehur me mosnjohje.
395	Korçë	Ilia	Bode	Bode	mosnjohje	
243	Korçë	Disi	Mansopli	Mansopli	mosnjohje	
324	Korçë	Marijana	Mitko	Terova (Fundo)	810	Mungese dokumentacioni
831	KORÇE	Babani	Babani	Babani	Mos miratim kerkese	Pronesia me hipoteke nuk ka planvendosje.
832	KORÇE	Kristaq	Rembeci	Rembeci	8000	Mungese dokumentacioni
834	KORÇE	Selit	Çudilert	Çudilert	Mos miratim kerkese	Mungese dokumentacioni
836	KORÇE	Thomaq	Terczi	Terczi	Mos miratim kerkese	Mungese dokumentacioni
837	KORÇE	Lisimak	Dishnica	Dishnica	24500	Pronesia me Kadastre nuk ka planvendosje.
838	KORÇE	Gaqo	Lubonja	Lubonja	Mos miratim kerkese	certifikata vertetim 7501. Me 496 dt. 20.01.2009 subjekti i jane trajtuar 2834 m ² truall

VIKTIMAT E REGJIMIT

Eshtrat e 'varrit masiv' të Dajtit 8 vite në morg, nis identifikimi i të pushkatuarve nga komunizmi

Fatmira Nikolli

Më 8 shkurt të vitit 2010 një qytetar zbuloi një 'varr masiv' në Dajt. Mbetjet e eshtrave të 13 personave të pushkatuar nga regjimi komunist u gjetën rrëzë malit në komunën e Linzës. Lokacioni i varrit masiv, rrëzë malit ishte rreth 50 m nga arkiva e Bashkisë së Tiranës. Zbulimi atëkohë qe disi rastësor. Një qytetar ishte vënë në kërkim të eshtrave të të atit vrrarë nga regjimi diktatorial komunist, kur gjatë procesit kërkimor, nxori në dritë skeletet e 13 trupave. Çështja u bë mediatike atëkohë dhe varri u gërmua nga ekspertë të fushës. Gazetarët në vendngjarje raportuan se eshtrat ishin në qese, por jo me pranga. Pas nxjerrjes së eshtrave prej aty, një oficer i policisë gjyqësore i dërgoi qeset me skelete në morgun e spitalit të Tiranës për ekspertizë të mëtejshme. Atëkohë, ish-të dënuar bënë me dije se zona njihej si zonë ku pushkatoheshin njerëz nga regjimi i egër komunist.

8 vite më vonë, eshtrat janë ende në morg, ende nuk janë identifikuar dhe nuk dihet se kush prehej rrëzë Dajtit, cila ishte historia e tij, pse u dënua dhe pse u pushkatua. Shteti shqiptar në 8 vite nuk ka arritur të identifikojë viktimat e komunizmit, ndonëse në anën tjetër ka familjarë që enden institucioneve në kërkim të dokumenteve që do të hidhnin dritë mbi vendin ku janë varrosur të afërmit.

8 vite më vonë, dje qeveria shqiptare përmes një VKM-je, ka miratuar në parim, marrëveshjen e bashkëpunimit, ndërmyjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP).

MARRËVESHJA

"Gazeta Shqiptare" ka kontaktuar dje Luigj Ndou, Zyrtar i lartë politik i ICMP-së (Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur) për të mësuar se në çfarë konsiston marrëveshja.

Ai pohoi se marrëveshja ka të bëjë me kërkimin e eshtrave të personave të zhdukur në komunizëm.

"Është një proces i qeverisë, e cila ka kërkuar ndihmë në procesin e identifikimit të personave që janë

Qeveria shqiptare firmos marrëveshjen me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur

Zyrtari i lartë, Luigj Ndou: Do të identifikohen eshtrat e gjetura në vitin 2010



zhdukur gjatë regjimit komunist, përfshirë edhe identifikim përmes ADN-së", tha Ndou.

Ai sqaroi se puna konkrete nis në momentin që marrëveshja miratohet në parlament dhe se projekti financohet nga Delegacioni i BE në Tiranë.

I pyetur se ku do nisë kërkimi dhe identifikimi i eshtrave të personave të zhdukur në komunizëm, nëse kanë lokacione të përcaktuara tashmë, Ndou, Zyrtar i Lartë Politik i ICMP-së, tha për 'GSH' se "projekti ka të bëjë me dy lokacione të ditura tashmë nga qeveria dhe me identifikimin e eshtrave që gjenden në morgun e Mjekësisë Ligjore në Tiranë të zhvarrosura në Dajt në vitin 2010".

Ndou tha se ICMP, e ka negociuar marrëveshjen e cila tanimë do të zbatohet e ka të bëjë me mbetjet njerëzore të viktimave të komunizmit. I pyetur për shtrirjen kohore, ai tha se kjo varet nga puna fillestare. "Në bazë të ecurisë së procesit mund të shtrihet në të gjithë territorin e Shqipërisë. Ne në këtë rast



Takimi i Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur me Gentjana Sulën në Tiranë

nuk e zëvendësojmë shtetin, ne jemi vetëm ndihmë".

NË KËRKIM TË ESHTRAVE

Në vigjilje të nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje mes qeverisë shqiptare dhe

ICMP për kërkimin, gjetjen dhe identifikimin e të zhdukurve gjatë diktaturës, kryetarja e Autoritetit të Dosjeve Gentiana Sula u takua me ekipin e ICMP për Ballkanin Perëndimor znj. Samira Krehic, zv/

udhëheqëse e Programit, Diana Sarzinski, bashkërenduese e mjekësisë ligjore dhe z. Ylber Morina e z. Luigj Ndou, zyrtarë të lartë. Takimi u bë duke qenë se arkivat kanë rol të rëndësishëm për plotë-

simin e informacionit aq të rëndësishëm në këtë proces. Atëkohë teksa premtonte angazhim dhe ndihmë nga ana e Autoritetit të Dosjeve, Gentiana Sula, do të zbulonte se "Në periudhën 1944-1991, në Shqipëri rreth 5 mijë individë janë ekzekutuar me vdekje, pjesa më e madhe e tyre me vendim gjyqësor, por disa prej tyre janë ekzekutuar pa një vendim gjyqësor. Trupat e tyre nuk i janë kthyer kurrë familjeve të tyre për t'i varrosur, në të kundërt ata janë varrosur në vende të pushenjuara pengjati terroristit të vendit. Ekzistojnë, gjithashtu, shumë dëshmi se qindra të burgosor politikë kanë vdekur në burgje dhe kampet e punës për shkak të torturave dhe për shkaqe të tjera - trupat e tyre rezultojnë ende të pagjetura".

Kryetarja e AIDSSH-së, do të tregonte se "gjyshi im Sulejman Mara është një prej tyre. Ai në moshën 45-vjeçare vdiq për arsye të paqarta në burgun e Burrelit dhe ende nuk ka një varr ku mund të shkojmë të vëmë një lule". Nisma për kërkimin dhe identifikimin e personave të zhdukur, viktimat të regjimit komunist në Shqipëri i ka filluar që prej vitit 2015. Atëkohë, Gentiana Sula (sot drejtuese e Autoritetit) në rolin e zëvendësministres së Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë qe angazhuar për këtë çështje me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur. "Pas miratimit të ligjit për hapjen e dosjeve të ish-sigurimit të shtetit, fillimi i programit për gjetjen e personave të zhdukur është një ndër vendimet më të rëndësishme politike të shtetit shqiptar që i shërben shkëputjes dhe distancimit nga krimet e komunizmit në Shqipëri. Hapja e dosjeve dhe fillimi i programit për gjetjen e të zhdukurve të diktaturës janë pjesë të një proces që synon dekomunizimin e vendit", shprehej kryeministri në vitin 2015. Sipas tij, heshitja e gjatë dhe e pafalshme rreth kësaj çështjeje, është një barrë e rëndë, që ngarkon jo vetëm ndërgjegjen morale të autoriteteve udhëheqëse politike të vendit gjatë 25 viteve të fundit, por edhe përgjegjësinë e tyre përballë legjislacionit kombëtar e ndërkombëtar për këtë fushë.

KERKIMI SHKENCOR



Nis hapja e dosjeve "Mbi rolin e shkencës në zhvillimin e shoqërisë gjatë viteve të para të vendosjes së regjimit komunist (1945-1954)"

Fatmira Nikolli



Takimi i djeshëm

Cilat qenë figurat e Gjergj Kokoshit, Eqrem Çabejt, Sabiha Kasimatit, Arshi Pipës, Odhise Paskalit, Aleks Budës, Ollga Plumbit, Petraq Pepos, Gjovalin Gjadrit dhe Petraq Qafokut? Ku u shkolluan, profilet e tyre, kërkimet shkencore që nisën a mbaruan, si u sosën jetët e tyre, dhe si u mykën në dosje punët e tyre? Kush mundi t'i mbijetonte presioneve, përgjimeve a shantazheve, në një epokë ku çdo gjë kontrollohej?

Për pyetje mbi këto e jo vetëm, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Projekti PERFORM - Shkencë Sociale Aktive dhe të Përgjegjshme pasi nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit "Mbi rolin e shkencës në zhvillimin e shoqërisë gjatë viteve të para të vendosjes së regjimit komunist (1945-1954)", dhe mbajtën takimin e parë. Bashkëpunimi synon të kontribuojë në ndërtimin e një narrative mbi rolin e shkencës, elitave intelektuale dhe kërkimit shkencor në vitet e para të vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri. Projekti mbi kujtesën ka gjetur mbështetjen e ambasadës së Zvicrës dhe dje, gjatë takimit të parë, historiania Sonila Boçi që do të drejtojë grupin e studiuesve që do të punojnë për të hedhur dritë mbi punën e 10 shkencëtarëve, sqaroi më shumë mbi projektin "Mbi rolin e shkencës në zhvillimin e shoqërisë gjatë viteve të para të vendosjes së regjimit komunist (1945-1954)".

TAKIMI

Boçi tha se për këtë studim do të hapen të gjitha dosjet. "Nuk na është refuzuar asnjë dosje që ne kemi kërkuar deri sot, por sigurisht që ka disa procedura që janë të njohura tashmë, në bazë të ligjit me të cilin operon Autoriteti dhe që krijon një lloj vështirësie kohore për të konsultuar të gjitha dokumentacionet". E pyetur për arkivat ku po kërkohet, Sonila Boçi tha se

Kur shkencëtarët refuzuan të bëhen marionetat

Nga Çabejt e Kasimati, Autoriteti i Dosjeve nis zbardhjen e dokumenteve për 10 emrat e njohur shqiptarë

në kërkimet e tyre përfshihen arkivat që administrohen nga Autoriteti, Fondet e Sigurimit të Shtetit, ato që kanë qenë pjesë e SHISH, ato që kanë qenë pjesë e arkivit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, fondet arkivore të Arkivit të Shtetit, fondin e Komitetit Qendror, fondet e Ministrisë së Arsimit, në fondet e Shkencës dhe fondet e ministrive, sepse një pjesë e personazheve vijjnë nga fusha të ndryshme. Grupi i studiuesve që po studiojnë 10 figura eminente të shkencës shqiptare të pasqirimit, ka intervistuar edhe personazhe, të afërm e të njohur të 10 sh-

kencëtarëve.

Boçi m pohon të ketë mangësi në dokumente. "Nuk më rezultoi. Deri tani kemi pasur përvojë të mirë kërkimi. Kolegët nuk kanë konstatuar mungesa në dosjet që kanë kërkuar.

E pyetur se çfarë i jep opinionit publik, ndërgjegjes sonë dhe raportit tonë me të shkuarën ky projekt dhe ky kërkim ndërfaqësor për të shkuarën janë të nxehta, Sonila Boçi tha se "kjo është pyetje që unë do t'i përgjigjem kur të kem rezultatit e kërkimit. Fakti që ne vendosëm të bëjmë një studim të tillë është për t'i kontribuar debatit

për të shkuarën. Ky është qëllimi ynë".

Ajo shtoi se këndvështrimi i grupit të studiuesve në këtë projekt është paksa i veçantë sa i takon studimit "Mbi rolin e shkencës në zhvillimin e shoqërisë gjatë viteve të para të vendosjes së regjimit komunist (1945-1954)". "Nuk është hasur në projekte të tjera, sepse është marrëdhënia e shtetit me shkencën dhe nga kjo derivon marrëdhënia e shtetit me intelektualët. Të fokusohesh në këto dy gjëra të rëndësishme them se jep një kontribut shumë të çmuar të së djeshmes dhe të sotmes. Normalisht nga mënyra se si

një shtet, një pushtet arrin të ndërveprojë me intelektualin, me njerëzit që duhet të përcaktojnë politikëbërjen e shtetit, flet shumë për atë vend. Besoj që rezultatet e kërkimit në këtë kontekst do të jenë shumë interesante", tha Boçi. E pyetur nëse do të përcillet lufta që kanë bërë intelektualët për të mos u bërë marioneta, historiania që drejton grupin e punës, tha se "nga aq dijeni sa kam në këtë fazë të parë të studimit, ka edhe përpjekje të këtyre shkencëtarëve për të qenë vetvetja dhe për të qenë korrekt me atë që besonin si profesionistë që ishin të fushave të ndryshme,

për të qenë të vërtetë me veten e tyre e për të mos u bërë marioneta dhe për të mos qenë lodra në duart e pushtetit, por sigurisht që është e vështirë në kuadër të një shteti diktatorial".

ZVICRA PËR LIRINË

Liria e individit, raporti i individit me lirinë në kohë të ndryshme dhe sidomos në të shkuarën, duket se u bënë shkas që ambasada zvicerane të mbështesë një projekt që hedh dritë mbi 10 figurat eminente të shkencës shqiptare të pasqirimit.

E pyetur se pse e mbështet këtë projekt ambasada Zvicerane, përfaqësuesja Elda Bagaviki tha për "GSH" se ambasada e Zvicrës ka një program kompleks që i referohet strategjisë së bashkëpunimit Zvicër-Shqipëri me një numër sektorësh të cilët janë prioritetet për qeverinë shqiptare e njëkohësisht edhe sektorë ku Zvicra mund të japë një kontribut, një vlerë të shtuar në sajë të përvojës, në sajë të traditës historike të saj. "Në këtë pikë, një nga programet e përgjithshme është mbështetja e shkencave sociale, për politikëbërjen. Ideja është lidhja e komunitetit të studiuesve me komunitetin e politikëbërjes në të gjitha nivelet. Ka disa aspekte, siç është fuqizimi i studiuesve të rinj dhe rritja e ndërgjegjesimit si nga ana e atyre që bëjnë politikë, por edhe e publikut të gjerë, për të kuptuar që ky është një proces kompleks që kërkon të gjitha palët", tha Bagaviki.

Sipas saj, janë një numër tematikash që janë zgjedhur për mbështetje. "Tematika e trajtimit të së shkuarës si një çështje e mbetur ende pezull në ndërgjegjen e shqiptarëve, zbulimi i së vërtetës dhe si mund të kontribuojë kjo çështje për jetën e sotme, duke hapur një diskutim publik, por duke iu referuar gjithmonë fakteve, është një prej tyre. Në këtë pikë ne patëm interesimin e drejtpërdrejtë të Autoritetit të Dosjeve, që në mënyrë proaktive kontaktoi ambasadën, por mbetet edhe në interesin e qeverisë zvicerane dhe politikave të saj, për të inkurajuar, dialogun publik e demokracinë e vërtetë", sqaroi Bagaviki. Në prononcimin e saj për "GSH" ajo tha se u gjet me interes të ndërsjellë çështja e së kaluarës. "Qasja e hartimit të politikave mbi evidencën, mbi kërkimin është integrale, kjo është vetëm një nga çështjet, sepse ne kemi nisma edhe me studiues të fushave të ndryshme. Jemi përpjekur të inkurajojmë një kërkim që jep rezultate, për politikë të zhvillimit", përfundoi ajo.



Sonila Boçi duke folur për "GSH"



Pritej të firmoste te Partizani

Besnik Prenga, trajneri i ri i Laçit

Laçi gjen pasuesin e Gentjan Mezanit. Do të jetë Besnik Prenga, trajneri i ri i skuadrës kurbinase, i cili do të drejtojë Laçin fillimisht në turin e parë kualifikues të Europa League dhe më pas në sezonin e ri të Kategorisë

Superiore. 47-vjeçari nga Mirdita nuk ka shumë eksperiencë në stol, por karriera e tij si futbollist ka qenë me të vërtetë e pasur. Besnik Prenga është edhe babai i mbrojtësit Herdi Prenga, i cili aktualisht është pjesë e skuadrës së

Inter Zapresic në kampionatin kroat. Për një periudhë të shkurtër, Besnik Prenga ka drejtuar dy skuadra në Kategorinë e Dytë të futbollit kroat fillimisht Hrv Dragovoljac dhe më pas Nk Lucko, ndërsa ka qenë edhe trajneri i

skuadrës së 19-vjeçarëve të Lokomotivës së Zagrebit. Laçi është stacioni më i lartë deri tani në karrierën si trajner për Besnik Prengën, ish-lojtarin e Partizanit dhe Dinamos së Zagrebit.

Mesfushori që shkëlqeu në testin e fundit deklaron se është gati të luftojë për një vend në Kombëtaren A

Taulant Seferi: Pres ftesën e Panuçit

Ndaj Bjellorusisë luajti si kapiten

Jeton Selimi



Taulant Seferi është një ndër futbollistët më premtues të Kombëtares shqiptare, i cili aktualisht aktivizohet për 21-vjeçarët e Shqipërisë. Në ndeshjen e fundit ndaj Bjellorusisë, Seferi mbajti edhe shiritin e kapitenit, ndërkohë që asistoi në golin e barazimit të shënuar nga Shefifi. Në një prononcim për "Vip Sport", Seferi ka folur në lidhje me skuadrën e 21-vjeçarëve, tek të cilët ka besim se një ditë ata do të bëhen lojtarë që do të na bëjnë



krenarë. Sa i përket Kombëtares A, Seferi thotë se

pret me kënaqësi ftesën nga Panuçi, duke pranuar

se do të punojë edhe më shumë, ndërkohë që Lorik

Cana është shembulli të cilin e ndjek futbollisti nga Kumanova. "Ndesha e parë si kapiten të them të drejtën ishte shumë domethënëse për mua, pasi të mbash shiritin e kapitenit të Kombëtares sonë është nder dhe krenari. Për këtë falënderoj trajnerin Bushi, i cili më dha shiritin. Afrimet e reja? Po ua them se kjo gjeneratë është shumë premtuese, pasi ka djem shumë të talentuar dhe besoj se do të kenë shumë sukses. Unë iu uroj të kenë shëndetin dhe të punojnë fort. Kam besim të plotë se

këto do të arrijnë në Europë dhe do të na bëjnë krenarë të gjithëve. Kombëtarja A? Mua më mbetet të punoj, ftesën e Panuçit do e kisha pritur me shumë gëzim dhe lumturi. Shpresoj të vazhdoj kështu, madje edhe më mirë dhe ta meritoj një ftesë nga Panuçi. Shembulli që ndjek? Padyshim që reja? Po ua them se kjo gjeneratë është shumë premtuese, pasi ka djem shumë të talentuar dhe besoj se do të kenë shumë sukses. Unë iu uroj të kenë shëndetin dhe të punojnë fort. Kam besim të plotë se

DËNOHET ISH-PRESIDENTI

Vodhi Dinamon e Zagrebit, burg për Mamiç

Zdravko Mamiç, ish-presidenti i Dinamos së Zagrebit në Kroaci, deri tani vonë këshilltar i klubit, vëllai i tij Zoran Mamiç, ish-drejtori sportiv Damir Vrbanoviç dhe zyrtari i autoritetit fiskal të vendit ballkanik, Milan Pernar janë shpallur fajtorë këtë të mërkurë për vjedhjen e rreth 116 milionë kunave nga klubi, duke i shkaktuar një dëm prej 12.2 milionë kunash buxhetit të shtetit, e të katërt janë dënuar me burgim. Mamiç personalisht është dënuar me 6 vite e gjysmë burgim. Si-



pas vendimit të lexuar nga kreu i Këshillit Gjyqësor, Darko Krušlin, Mamiç janë shpallur fajtorë për të gjitha akuzat e ngritura mbi të. Milan Pernar dhe Zoran Mamiç u shpallën të pafa-

jshëm për një nga akuzat, por rezultuan fajtorë për rolin e uljes së detyrimeve fiskale të Mamiçit, apo për marrje e dhënie ryshfeti. Zdravko, Zoran dhe Vrbanoviç janë fajësuar gjithashtu

për vjedhje të parave nga transferimi i Dejan Lovren, ndërsa vetëm Zdravko ka vjedhur para të nga transferimi i Luka Modriç. Për këto akuzat, Pernar është dënuar me 4 vite e dy muaj, Zoran për 4 vite e 11 muaj, ndërsa Vrbanoviç me 3 vite burgim. Asnjë prej të pandehurve nuk ishin të pranishëm në gjykatë kur u dha vendimi. Por, ajo që bën çudi është se Zdravko Mamiç njoftoi ditën e djeshme një ditë para marrjes së vendimit se ndodhej në Medjugorje të Bosnje-Hercegovinës, edhe pse deklaroi se nuk po iu shmangej autoriteteve.

ISH-TRAJNERI KUQEZI


De Biazzi drejt Zvicrës, Lugano i ofron stolin

Ish-trajneri i Kombëtares shqiptare, Xhani De Biazzi pritet që të rikthehet sërish në pankinë pas një periudhe pushimi, ndërsa aventura me Alaveshin nuk përfundoi në mënyrën më të mirë. Në media kohët e fundit ishte përfolur se tekniku italian po kërkonte një tjetër eksperiencë të re në drejtimin e një Kombëtareje, pas suksesit historik me Shqipërinë, por sipas të gjitha gjasave, ai do të përfundojë në Zvicër sipas asaj që raporton "Tuttomercatoëeb", De Biazzi ka marrë një of-



ertë konkrete nga Lugano, ndërsa në këtë moment janë duke u diskutuar vetëm termat financiarë, përpara arrijtes së marrëveshjes.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Niven që qe aktor.
5. Little... kryeqyteti i Arkansas.
7. Janë tek në lakër.
10. Nuk ka akoma një bebe.
11. Kufizojnë katete.
12. Penn aktor.
13. Hector që shkroi Pa familje.
15. Thahen me bonifikime.
18. Mbyllin takimin.
19. Ndërmarrje Industriale Mat.
21. Mbyllën me epilog.
23. Tregohen indiferentë dhe aspak të gjallë.
25. Ishin sandalet e lëkurëkuqve.
27. Njëloj për fatmë.
30. Eshhtë vend si Katar.
31. Pupi regjisor.
32. Janë strehat e çobanëve.
33. Eshhtë centrali si Chernobyl.

35. Fillojnë një argument.
36. Të parat në stadium.
37. Mund të sjellin shi.
38. Kështu fillon Odisea.
39. Një mund të jetë emërore.
42. Thirrej edhe kështu Persefoni.
44. Ai dhe ajo.
45. E ka lënë atë që s'ka fuqi
48. Para es Salaam.
49. Ylli i Londrës.
50. Eshhtë syzë... në komo.

VERTIKALI

1. Hyskja aktor.
2. Kush e thotë lutet.
3. Një tis mjegulle.
4. Maidën që këndojnë.
5. Gjysmë rekord.
6. Antonio skulptor i famshëm.
7. David regjisor.
8. Janë brinjë në skuadër.
9. Ruan në kufij.
12. Mban mikrofonin.
14. Janë edhe ato të fytyrës.

16. Qureshin edhe Eumenide.
17. Demek pa kufij.
20. Mund të jetë atomike.
22. Qyteti i përjetshëm.
24. Kitarë e Ravi Shankar.
25. Janë katrore në sipërfaqe.
26. Një fjalë si gjoja.
28. Pak daktilografi.
29. Eshhtë si divan.
31. Një pjesë e amerikanëve.
32. Bernhardt që qe aktore.
34. Eshhtë infeksion në veshë.
38. Një mund të jetë unik
40. Gjysma e sasisë.
41. Pak marramendëse.
43. Eshhtë dhomë.
45. Fillojnë takimin.
46. Në fund majtas.
47. Të fundit në manastir.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

1. E bardhë ajo Moby Dick.
5. Fillojnë amplifikimin.
7. Eshhtë vit që parashikohet.
10. Mbyllin pamjen.
11. U printe jenicerëve.
13. Thurman aktore.
14. Një reaksion në provëz.
16. Një sport me brez të zi.
19. Në fund të fundit.
20. Janë në gjyq.
23. I është hequr të dënuarit.
24. Eshhtë shahu i fundit
25. Janë fletë trëndafili.
27. Kufizojnë një metër.
28. Tregojnë pallate në miniaturë.
29. Një fjalë pa shkak.
30. Janë përlogaritje.
32. Mbyllin një ditare.
33. Të parat në muzg.

VERTIKALI


34. Me të nxjerrin një letër.
35. Janë me ngjyra të tilla si tunxhi.
37. Toromani balerinë.
40. Fillojnë politikën.
42. Një piktor si Antonio Ligabue.
44. Diftong në dietë.
46. Një lind në kokë.
48. Kush ka... do të pijë.
49. Punojnë në galeri.
52. Fillojnë titrat.
53. Mund të jetë ekspres.
54. Mund të skadojë.

1. Ishte titulli i Hiro Hitos.
2. Ekberg aktore.
3. Eshhtë skuadra.
4. Dy asa.




5. Binjaket në klasa.
6. Qe duhet sajdisir.
7. Nuk i bihet me kokë.
8. Sharif aktor.
9. Janë organet e taksave.
12. Me Haensel në përallat e vëllezërve Grimm.
15. Vihen për të mbyllur.
17. Janë vegla.
18. Eshhtë medalja e të parit.
21. I dhimbset frikacakut.
22. Mund të jetë mbi xhiro.
26. Eshhtë llahtar.
28. Janë inatë të akumuluar
30. Eshhtë vëlla i gruas.
31. Një tip për të këcyer.
33. Edoard piktor.
36. Lumë në Francë.
38. Janë djemtë e... nënës.
41. Lindi Akilin.
43. Kodi i celularit.
45. Mbledh baskët separatistë
47. Një është edhe Egjeu.
49. Fillojnë një metodë.
50. Dy anët e një neni.
51. Fillojnë ofensivën.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

								9
	4	7	6					
8				2	4			
		4	3	9				5
	9			8				
	1	6		5			9	2
3				8				9
				1	2			
	2	7						4

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

5	9	8	6	1	2	4	7	3
2	4	7	3	5	8	1	6	9
1	3	6	4	9	7	8	2	5
8	7	3	9	4	5	6	1	2
4	5	9	1	2	6	7	3	8
6	1	2	7	8	3	5	9	4
7	2	4	5	3	1	9	8	6
9	8	1	2	6	4	3	5	7
3	6	5	8	7	9	2	4	1

Argëtim filozofik

- Te jesh gjithmonë i ndersëm me veten, është një ushtrim i këndshëm. (Sigmund Freud)
- Vlera e një njeriu duhet parë në faktin se çfarë jep, dhe jo në atë se çfarë është në gjendje të marrë. (Albert Anjshajtajn)
- Liria është që të mos të trazojë njeri ty dhe ti të mos të trazosh të tjerët.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

8	A	1	11	16	7	5	15	8	3	8		
1	Z	8	13	8	6	6	8	4	3	8	12	
2	I	7	10	8	9	2	15	2	11	3	2	
9	L	14	8	12	17	12	3	7	9	9	2	
		5	7	15	5	8	5	2	16	8	5	16
4	8	6	5	2	15	8	7	15	10	7		
7	5	7	12	7	15	6	11	6	8	15		
5	6	4	7	5	2	18	2	11	19	7		
5	4	11	6	19	9	8	4	8	6			
9	11	15	1	7	5	8	19	8	1	8		
7	6	2	14	14	7	16	11	15	7			
5	7	8	4	8	9	3	8	15	7	5		

A	Z	O	V	E	T	N	A	B	A	
Z	A	G	A	R	R	A	M	B	A	S
I	C	K	A	L	I	N	I	O	B	I
L	C	A	S	U	S	B	E	L	L	I
T	E	N	T	A	T	I	V	A	T	V
M	A	R	T	I	N	A	E	N	K	E
E	T	E	S	E	N	R	O	M	A	N
T	I	M	E	T	I	P	I	A	F	E
A	M	O	R	F	R	A	F	A	Z	A
L	O	N	Z	E	T	A	F	A	Z	A
E	R	I	C	C	E	V	O	N	E	
T	E	A	M	A	L	B	A	N	E	T

- Nëse rrezikon mund të humbasësh,
- nëse nuk rrezikon ke humbur gjithësesi
- - Singërit është të kesh qiellin dhe të duash vetëm një yll.. të kesh detin e të duash vetëm një pikë uje, ta kesh boten dhe ta duash vetem një njeri
- - Tre parimet e mëdha të së bukurës
- janë: thjeshtësia, e vërteta dhe natyrshmëria
- Vepra e vetme, për të cilën nuk dihet
- shpërblimi, është durimi

Thënie të mëdha

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

S	E	V	E	N	U	P	S	T	E	E	F	I
A	M	I	N	K	A	P	I	T	A	L	I	
R	I	T	E	T	R	E	L	R	E	L	A	M
A	T	E	F	F	I	L	O	K	E	T	I	K
H	E	E	K	A	M	T	K	A	Z	E	K	
A	P	R	O	T	O	K	O	L	L	A	R	E
K	A	T	A	M	A	R	A	N	I	O	T	
I	R	G	O	L	I	N	R	O	M	Y		
T	E	M	A	E	I	B	O	R	I	S		
A	N	I	T	A	M	I	L	A	N	O		
R	A	N	I	V	I	T	M	J	E	R	A	N
E	T	I	L	E	N	F	R	A	T	I		

FJALËKRYQI (2)

B	A	O	B	A	B	P	E	D	A	N	A	T
R	R	P	E	R	I	P	A	T	E	I	T	K
A	P	E	L	R	I	V	B	N	A	R		
V	E	L	R	I	V	A	M	I	D	A	M	
A	R	K	O	L	O	R	I	T	I	L	E	
A	P	R	O	T	A	G	O	N	I	S	T	E
K	A	N	T	A	T	A	T	K	A	T	E	
A	R	I	E	L	T	A	U	R	T			
S	A	L	A	S	T	I	K	T	S			
T	A	E	S	I	V	T	I	R	N	T		
I	R	R	M	I	B	A	N	O	R	E	T	
K	R	A	T	E	R	E	T	G	J	I	R	I

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL



- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al



Tashmë edhe lundroni!

